

BASHKIA GRAMSH



2021-2023

Plani Social i Bashkisë Gramsh u përgatit nga ESA Consulting me mbështetjen e UNICEF dhe të Programit “Askush të mos mbetet pas” të Kombeve të Bashkuara. Ky program është i angazhuar për të mbështetur reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mundësuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë.

Në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë qendrore ky program po mbështet Bashkitë për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar Planet Sociale Lokale. Ligji nr. 121/2016 “Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së këtyre Planeve bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e tyre. Edhe pse qeverisja lokale ka tashmë një nivel të ngritur të ndërgjegjësimit mbi nevojën për të ngritur e bërë funksional një sistem komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për ata që kanë nevojë për këto shërbime, ajo ka kapacitete të kufizuara teknike dhe financiare për ti hartuar dhe kostuar planet e veprimit.

Objektivi i këtij programi katër vjeçar (2017 – 2021) është fuqizimi i personave dhe grupeve vulnerabël për të patur akses të barabartë në shërbimet publike, për të patur zë në vendimarrjet që ndikojnë mbi jetën e tyre dhe për të kërkuar përgjegjshmëri nga ata që kanë funksione publike. Grupet e targetuara drejtpërdrejtë ose indirekt nga shërbimet e përmirësuara sociale janë popullsia e marginalizuar në Shqipëri, ku ndër grupet më vulnerabël janë më shpesh personat me aftësi të kufizuara, romët dhe egjiptianët, fëmijët dhe gratë. Përmirësimi i përfshirjes së tyre sociale po mbështetet nga ndërhyrje në nivelin makro (qeveria qendrore dhe shërbimet kombëtare), nivelit lokal (bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile) si dhe në nivelin mikro duke përfshirë aktivisht grupet e targetuara nga projekti në procesin e zbatimit të tij.

PERMBAJTJA

HYRJE	4
1. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE	6
1.1 Vizioni	6
1.2 Misioni	6
1.3 Parimet udhërrëfyese	7
2. ANALIZA E SITUATËS	8
2.1 Kuadri Strategjik	8
2.2 Nevojat, shërbimet e ofruara dhe mangësitë	12
2.2.1. Vlerësimi i nevojave	12
2.2.2. Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve	21
2.2.3. Mangësitë - nevojat e paplotësuara	28
2.2.4. Analiza SWOT	33
3. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	36
4. PLANI I VEPRIMIT	53
5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	75
6. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT	77
REFERENCAT	78
SHTOJCA 1: PROFILI DHE KARAKTERISTIKAT E KATEGORIVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR	81
SHTOJCA 2. SHPORTA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR	85
SHTOJCA 4. BUXHETI I DETAJUAR	89

HYRJE

Bashkia Gramsh bën pjesë në qarkun e Elbasanit dhe kufizohet në veri me bashkinë Elbasan, në lindje me bashkinë Pogradec, në jug-lindje me bashkinë Maliq, në jug me bashkinë Skrapar dhe në perëndim me bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik.

Numri i popullsisë të rregjistruar në gjendjen civile në janar 2020 në këtë Bashki është 35,149 banorë¹, por të dhënat e Censurit të vitit 2011 japin një popullsi prej 24,231 banorë me densitet 32.78 banorë për km². Pra në përputhje me Censusin 69% e popullsisë së rregjistruar në gjendjen civile jetojnë në këtë Bashki, pjesa tjetër ka lëvizur në drejtim të qyteteve të mëdha apo në emigrim. 12,187 familje rezultojnë të rregjistruara në gjendjen civile. Numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve në këtë Bashki është 2,9.

Bashkia ka sipërfaqe 739,22 km² dhe është e organizuar në 10 njësi administrative, të cilat kanë në përbërje një qytet dhe 94 fshatra. Popullsia është e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në njësitë administrative të Bashkisë. 46% e popullsisë është e rregjistruar në njësitë administrative Gramsh, Skënderbegas dhe Kushovë, 28% në Pishaj, Sult dhe Poroçan, 12% në Kodovjat dhe Lenie, ndërsa në Kukur 8% dhe Tunjë 6%.

Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, si dhe ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” kanë përcaktuar detyrimin e Bashkisë për të ngritur në territorin e saj shërbime të kujdesit shoqëror që në thelb synojnë fuqizimin, përfshirjen, rintegrimimin apo reabilitimin dhe zhvillimin e atyre pjesëtarëve të komunitetit që i kanë të nevojshme këto shërbime. Në përputhje me këtë detyrim ligjor Bashkia Gramsh e mbështetur nga UNICEF përmes programit “Leave No One Behind” dhe konsulentë të “ESA Consulting” nisi në maj 2020 procesin e hartimit të Planit Social 2021-2023. Hartimit të këtij Plani i parapriu Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror, i cili identifikoi grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë, madhësinë e këtyre grupeve, shtrirjen e tyre në territor, shërbimet egzistuese që adresojnë nevojat e tyre, si dhe kapacitetet e burimet njerëzore e financiare të Bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Grupi lokal i Bashkisë i përbërë nga stafi i Sektorit i ndihmës dhe shërbimit social, administratorët shoqëror në njësitë administrative, të mbështetur nga konsulenti kombëtar përdorën përgjatë procesit të identifikimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror kombinim të teknikave të ndryshme: (1) U analizua legjislacioni kombëtar për të identifikuar standartin udhërrëfyës në fushën e shërbimeve të

¹ Të dhëna të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

kujdesit shoqëror². U kërkuan Plane strategjike të mundshme lokale dhe procedura pune që ndiqen në këtë Bashki. U konsultua Rregullorja e Brendshme e Bashkisë për të identifikuar rolet dhe funksionet jo vetëm të strukturave egzistuese në Bashki në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe të njësive të tjera brenda Bashkisë me të cilat duhej ndërvepruar gjatë fazës së përgatitjes së Planit Social; (2) U identifikuan dhe u mbledhën një numër të dhënash statistikore dhe administrative nga institucione kombëtare dhe lokale, si: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Administratorët shoqëror, Sektori i ndihmës dhe shërbimit social, Rregjistri Elektronik Kombëtar i Ndihmës Ekonomike, Zyra e Punës, Strukturat Arsimore, Shëndetësore dhe Policia. Të dhënat u mbledhën në muajt Maj-qershor 2020. (3) Konsulentët e ESA Consulting analizuan të dhënat e mbledhura dhe përmes krahasimit me standartin kombëtar hartuan draftin e Raportit të Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror. (4) Raporti dhe gjetjet e tij fillestare u konsultuan në një tryezë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të strukturave të policisë, Zyra e Punës, struktura shëndetësore, Sektori i ndihmës dhe shërbimit social, zyra e financës, urbanistikës, administratorë shoqëror, Forumi i Pavarur i Gruas Elbasan. Ttryeza mundësoi saktësimin e të dhënave e gjetjeve të Raportit, si dhe identifikoi prioritetet për ngritjen e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Gramsh. (5) Në kushtet e pandemisë së Covid-19 dhe pamundësisë për të zhvilluar fokus grupe me përfaqësues të grupeve të identifikuara në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, u zhvilluan gjithashtu intervista gjysëm të strukturuar me një kampion përfaqësues të këtyre grupeve, me qëllim marrjen e këndvështrimit të tyre mbi shërbimet që duhet të ngrihen në këtë Bashki.

Analiza mbi grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror tregoi se 10,440 individë ose 30% e popullsisë së Bashkisë Gramsh ka të nevojshme të paktën një formë shërbimi kujdesi shoqëror. Pëshën kryesore në këtë numër e mbajnë individët pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara. Arsyet kryesore të një niveli të lartë të kërkesës për ndihmë ekonomike në këtë Bashki lidhen me nivelin e zhvillimit ekonomik. Bashkia e Gramshit shtrihet në një territor shumë malor në Shqipërinë qendrore, ku toka bujqësore është e paktë (rreth 14 për qind e sipërfaqes) ndërsa pjesa tjetër e territorit është zonë pyjore ose kullotë. Zona rurale ka numrin më të lartë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Edhe familjet që zotërojnë toka nuk arrijnë të gjenerojnë të ardhura për disa arsye: tokat nuk janë prodhimtare, janë kryesisht toka në zona kodrinore, mungon sistemi i ujitjes dhe vaditjes, ka mungesa në infrastrukturën rrugore. Shpenzimet për të mbjellë janë më të mëdha se sa prodhim u jep toka. Fshatrat janë shumë të shpërndarë e të largët nga tregu, infrastruktura rrugore është e keqe. Nuk ka treg për shitje si dhe mungojnë pikat e grumbullimit. Agjencia Rajonale e Zhvillimit të Bujqësisë subvencionon për bletët dhe

² Tek Referencat gjeni paketën e plotë legjislativë të konsultuar

bagëtinë. Mungesa e infrastrukturës rrugore nuk krijon mundësi edhe për zhvillimin e turizmit. Në territorin e Bashkisë ka zona që mund të shfrytëzohen për turizëm (kanionet etj), por ato janë ende të paaksesueshme lehtësisht për turistët. Qyteti i Gramshit numëron rreth 300 biznese të regjistruara, shumica prej të cilave janë biznese të vogla tregtie apo shërbimesh, pra në zonën urbane mungojnë vendet e punës. Deri para një viti ishin hidrocentralet që mundësuan rritjen e punësimit, aktualisht vihet re një rënie e vendeve të punës në këtë Bashki. Pandemia ka përkeqësuar akoma më shumë situatën në të gjithë territorin e Bashkisë. Në këto kushte Bashkia duhet të zhvillojë me prioritet programe që nxisin fuqizimin ekonomik të këtyre familjeve, sikurse duhet të zhvillojë forma shërbimesh kujdesi shoqëror sipas nevojave specifike të çdo grupi të identifikuar.

Kundrejt kësaj nevoje të lartë për shërbime në Bashkinë Gramsh është ngritur dhe funksionon vetëm një qendër ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Bashkia ka ndërtuar gjithashtu partneritetin me një ofrues jo publik shërbimi duke adresuar një pjesë të nevojave të viktimave të dhunës në familje. Analiza tregoi se Bashkia ka alokuar një numër të kufizuar burimesh njerëzore, si dhe ka mungesa në buxhetin e nevojshëm për të financuar ngritjen e shërbimeve të nevojshme për t'ju përgjigjur detyrimeve ligjore.

Plani Social 2021-2023 ngrihet mbi nevojat e vlerësuara, kapacitetet, mundësitë dhe prioritetet e formuluar në konsultim me aktorë publikë, jopublik dhe përfaqësues të komunitetit dhe përmes masave konkrete do të mundësojë ngritjen e sistemit komunitar të koordinuar të shërbimeve të kujdesit shoqëror që do të adresojë nevojat në zhvillim për fuqizim, përfshirje, zhvillim e riintegrim të çdo individi pjesë e komunitetit në Bashkinë Gramsh.

1. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

1.1 Vizioni

Ndërtimi i një sistemi komunitar shërbimesh të kujdesit shoqëror që shmang pabarazinë sociale ekonomike, parandalon rënien në varfëri dhe përjashtimin social, mbron, fuqizon dhe riintegron çdo pjesëtar të komunitetit.

1.2 Misioni

Bashkia Gramsh do të garantojë shërbime komunitare të kujdesit shoqëror në përputhje me standartet kombëtare, për të përmirësuar jetën e çdo individi në situatë të pafavorshme, të

përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

1.3 Parimet udhërrëfyese

Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes dhe kujdesit social do ta ketë bazën tek parimet universale të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë tek:

- *Parimi i universalitetit.* Shërbimet e kujdesit shoqëror do të krijohen, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një *sistem rregullash ligjore* që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.
- *Parimi i drejtësisë sociale.* Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.
- *Parimi i subsidiaritetit.* Shërbimet e kujdesit shoqëror do të ofrohen *sa më pranë qytetarëve* dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.
- *Parimi i mbështetjes shoqërore.* Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, do të kenë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.
- *Parimi i deinstitutionalizimit.* Shërbimet e kujdesit shoqëror do të sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.
- *Parimi i partneritetit.* Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore do të bazohet në një *bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore*, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

- *Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit.* Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.
- *Parimi i mosdiskriminimit.* Do të ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.
- *Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.* Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, do të jenë konfidenciale dhe do të mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të ruajë konfidencialitetin e të dhënave personale të individit për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit do të shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

2. ANALIZA E SITUATËS

2.1 Kuadri Strategjik

Në fushën e mbrojtjes dhe përkujdesit social politikat dhe strategjitë lokale duhet të formulohen në përputhje me nevojat e vlerësuara të individëve apo grupeve të rrezikuara nga varfëria apo përjashtimi social, si dhe duhet të udhëhiqen nga legjislacioni dhe standartet kombëtare. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes sociale 2020-2023 dhe Plani i Veprimit të saj ka përcaktuar si një nga objektivat e tij ngritjen e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar deri në vitin 2023³. Ky objektiv sipas strategjisë do të realizohet nëpërmjet: (i) Plotësimit dhe qartësimit të politikave që përcaktojnë reformën e programit të shërbimeve të kujdesit shoqëror; ii. Plotësimit të akteve nënligjore që do të hapin rrugën për zbatimin e reformës; iii. Përmirësimit të kuadrit institucional për strukturat përgjegjëse për programin e kujdesit shoqëror; iv. Krijimit të instrumenteve për hartimin dhe monitorimin e Planeve sociale vendore; v) Hartimit të instrumenteve si pjesë e kuadrit rregullator në ndihmë të autoriteteve rajonale/vendore; vi. Zbatimit të Fondit Social për të

³ Vendim i Këshillit të Ministrave nr.866, datë 24.12.2019, “Për për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj.

mbështetur kujdesin shoqëror përmes shërbimeve të reja dhe novatore.”⁴ Siç shihet për të ngritur sistemin kombëtar Strategjia parashikon ngritjen e sistemeve funksionale të integruara të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shëndetësorë në njësitë e qeverisjes vendore. Për ti ngritur këto sisteme parashikohet së pari ngritja e strukturave/njësisve të vlerësimit të nevojave dhe referimit për shërbime shoqërore në nivel vendor, si pjesë qendrore e drejtorive të mbrojtjes sociale, të cilat kanë detyrimin ligjor të hartojnë planet sociale vendore. Tërësia e planeve sociale vendore të zhvilluara në nivel lokal sipas përcaktimeve të ligjit të ri të shërbimeve sociale dhe integrimi i tyre do të përbëjë bazën për hartimin e hartës së shërbimeve shoqërore në shkallë kombëtare.

Ngritja e sistemeve komunitare të shërbimeve të kujdesit shoqëror është përgjegjësi e çdo Bashkie, kjo në përputhje si me Ligjin nr.13/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ashtu edhe me Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

Sipas Ligjit nr.13/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”⁵, neni 24, Bashkia ka funksionin e krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë. Ligji nr.121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij rregullojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në mënyrë të posaçme procesin e ofrimit të shërbimeve nga organet publike në nivel vendor të ngarkuara sipas Ligjit. Neni 36 i këtij Ligji ngarkon Bashkinë për të ofruar dhe administruar shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke: identifikuar nevojat; vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit; hartuar planin social vendor; programuar buxhetet vendore; planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore; kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 518, date 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, në pikën 2 të tij ka përcaktuar këto forma të shërbimeve të kujdesit shoqëror: a) Shërbime parashoqërore, ku përfshihen informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi on-line; b) Shërbime në komunitet, ku përfshihen shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditë dhe gjysmëditë, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët; c) Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara⁶. Kjo shportë shërbimesh është udhërrëfyese në ngritjen e sistemit komunitar të

⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr.866, datë 24.12.2019, Fq.21

⁵ http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/pushteti%20vendor_varianti%20perfundimtar.pdf

⁶ Në Shtojcën 3 gjeni të detajuar shërbimet e kujdesit shoqëror që përfshihen në këtë VKM

shërbimeve të kujdesit shoqëror për Bashkinë e vendosur në kontekstin lokal sipas nevojave për shërbime të identifikuara.

Financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror është gjithashtu i rregulluar tashmë nga ligji dhe aktet nënligjore të tij. Ligji 121/2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, por edhe aktet nënligjore të miratuara në mbështetje të tij kanë kushtëzuar financimin nga qeveria qendrore të shërbimeve komunitare të Bashkisë me egzistencën e Planit Social të saj. Specifikisht pika 4.3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social” përcakton se “Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, të cilat u transferohen njësisive të vetëqeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime, bazuar në planet sociale të buxhetuara”. Nënvizojmë se në përputhje me ligjin por dhe pikën 2 të VKM së lartpërmendur “Fondi social krijohet me burime financiare, nga: a) fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; b) fondet nga buxhetet e njësisive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; ç) tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, ka përcaktuar mekanizmin e financimit nga Qeveria qendrore, si dhe metodologjinë e përlllogaritjes së fondeve që do të furnizojnë Fondin Social që ngre Bashkia. Sipas këtij vendimi procedura e llogaritjes së financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshin: (1) hartimin e Raportit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror, si dhe planin social të Bashkisë për periudhën trevjeçare. (2) Miratimin në Këshillin bashkiak të planit social trevjeçar të buxhetuar, si dhe kërkesës për financim nga buxheti i shtetit, brenda muajit shkurt të çdo viti, për atë pjesë të planit që mbetet i pambështetur nga buxheti i bashkisë. (3) Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, duke u bazuar në planet sociale vendore të buxhetuara dhe në prioritetet kombëtare për shtrirjen e shërbimeve shoqërore, parashikon në buxhetin e saj të vitit të ardhshëm, fonde për financimin e Fondit Social. Ky Vendim ka përcaktuar gjithashtu formatin e Raportit të Vlerësimit të Nevojave që i paraprin hartimit të Planit Social, sikurse dhe komponentët e këtij Plani të cilat janë mbajtur në konsideratë në ndërtimin e Planit Social të Bashkisë.

Për të ngritur sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror Bashkitë duhet të kenë jo vetëm buxhetin, por edhe burimet e nevojshme njerëzore për të përmbushur funksionet e parashikuara në ligj. Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 36 të Ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit

shoqëror dhe pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njëسيا e vlerësimit të nevojave dhe referimit. Konkretisht: (i) Struktura përgjegjëse në nivelin e Bashkisë përveç planifikimit, organizimit, prokurimit dhe monitorimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duhet të përmbushë funksione që rrjedhin nga: Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale"⁷, Ligji 47/2018 "Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"⁸, Ligji⁹ nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Në përputhje me ligjin Ligji 47/2018 "Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" njësitë e qeverisjes vendore kanë këto detyra: (i) angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje; (ii) instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre; (iii) ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse; (iv) Monitorimin e situatës së viktimës së dhunës në familje gjatë gjithë vlefshmërisë së urdhërit të mbrojtjes. Sipas VKM Nr.334, datë 17.2.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij" struktura përgjegjëse e shërbimit të kujdesit shoqëror në Bashki duhet të ketë në përbërje të saj edhe koordinatorin vendor për adresimin e dhunës në familje. Në përputhje me VKM e sipërcituar Bashkitë kanë detyrimin për ngritjen dhe funksionimin e: (i) Komiteteve Drejtuese lokale që drejtohen nga Kryetari i Bashkisë dhe janë komitete koordinuese ad hoc; (ii) Ekipi teknik ndërdisiplinor që ngrihet me vendim të komitetit drejtues më qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje; (iii) Pranë çdo bashkie caktohet koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore;

Në këndvështrimin e garantimit të mbrojtjes që duhet ti mundësohet çdo fëmije, Ligji¹⁰ nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcakton mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, bashkë me detyrat specifike që garantojnë ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave me efektivitet, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Në kreun III "Mekanizmat institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", neni 34 grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative përcaktohet si mekanizmi këshillimor

⁷ Ligji Nr.9355, datë 10.03.2005, ndryshuar me ligjin nr. 9602 datë 28.07.2006, ligjin nr. 10252 datë 11.03.2010, ligjin nr.25/2013, ligjin nr. 47/2014, ligjin nr. 44/2016 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore".

⁸ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" të ndryshuar me Ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010.

⁹http://www.amshc.gov.al/ëeb/doc/ligjore/Ligj_18-2017_Per_Te_Drejtat_dhe_Mbrojtjen_e_Femijes.pdf

¹⁰http://www.amshc.gov.al/ëeb/doc/ligjore/Ligj_18-2017_Per_Te_Drejtat_dhe_Mbrojtjen_e_Femijes.pdf

dhe koordinues institucional në nivelin vendor. Sipas këtij ligji strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë: (i) Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; (ii) Njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; (iii) Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative; (iv) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Në çdo njësi administrative në varësi të Bashkisë, me përjashtim të Bashkive me më pak së 6 mijë banorë, ngrihet Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit¹¹, e cila siguron: (i) identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë; (ii) vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë; (iii) informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla; (iv) hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; (v) bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm; (vi) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit; (vii) mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar. (viii) hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar sipas përcaktimit të nenit 29, pika 2 të ligjit 121/2016. (ix) kryen funksione që lidhen me administrimin e pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Për të realizuar funksionet e përcaktuara Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Rasteve, duhet të ketë të paktën: një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6000 deri në 10 000 banorë; një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë¹²; një administrator shoqëror¹³;

2.2 Nevojat, shërbimet e ofruara dhe mangësitë

2.2. 1. Vlerësimi i nevojave¹⁴

¹¹ Nenet 36 dhe 37 të ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"

¹² Kjo në përputhje me Ligjin "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

¹³ Detyra sipas Ligjit "Për asistencën sociale"

¹⁴ Në Shtojcën 1 gjëni Treguesit e detajuar të analizuar

1. Individë në familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme

Në Bashkinë Gramsh aktualisht 19,3% e familjeve janë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Nga 2,395 familje që aplikuan për përfitim e ndihmës ekonomike 2,358 familje në Bashkinë Gramsh e përfituan atë në prill 2020¹⁵. Niveli i përfshirjes në skemën e ndihmës ekonomike është aktualisht 99%.

Skema e ndihmës ekonomike në këtë Bashki është e qëndrueshme. Në dhjetor 2018 përfituan ndihmë ekonomike 2,385 familje nga 2,460 familje që aplikuan për ta përfituar atë. Pra rënia në skemën e ndihmës ekonomike në një hark kohor prej 16 muajsh është vetëm 1,2%. Krahasuar dy periudhave ka një rritje të kërkesës për ndihmë ekonomike e për rrjedhojë dhe të numrit të familjeve përfituese në njësinë administrative Gramsh, ku aktualisht përfitojnë ndihmë ekonomike 18 familje më shumë se në dhjetor 2018.

Shpërndarja në territor e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike varion. Referuar numrit të përgjithshëm të familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike 31% e tyre jetojnë një Pishaj, Pult dhe Poroçan; 27% në Gramsh, Skënderbegas dhe Kushovë; 19% në Kodovjat dhe Lenie; 14% në Kukur; 9% në Tunjë.

Nëse i referohemi përqindjes që zenë familjet përfituese të ndihmës ekonomike në numrin e familjeve për çdo njësi administrative shohim se pamundësinë më të madhe për të siguruar të ardhura e kanë:


Kukur- 34% e familjeve përfitojnë ndihmën ekonomike

Kodovjat dhe Lenie – 31% e familjeve përfitojnë N.E

Tunjë – 30% e familjeve

Pishaj, Sult dhe Poroçan – 22% e familjeve

Gramsh, Skënderbegas dhe Kushovë- 11% e familjeve




¹⁵ Të dhëna të Rregjistrat Elektronik Kombëtar të Ndihmës ekonomike.

Fuqizimi ekonomik i familjeve është i rëndësishëm, por për ta mundësuar kërkohen masa konkrete që mbajnë në konsideratë karakteristikat e këtyre familjeve.

Pjesë e 2,358 familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike janë 8,990 individë. Thënë ndryshe 26% e popullsisë së rregjistruar në gjendjen civile në këtë Bashki janë pjesë e familjeve me të ardhura të pamjaftueshme. Në përbërje të 2,358 familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike janë (i) 2,552 fëmijë, pra 30% e fëmijë të rregjistruar në gjendjen civile në këtë Bashki janë pjesë e familjeve me të ardhura të pamjaftueshme; (ii) 6,334 individë në moshë pune dhe (iii) 104 individë në moshë pensjoni. 25% e popullsisë në moshë mbi 18 vjeç janë pjesë e familjeve me të ardhura të pamjaftueshme

Familjet më të varfëra në tërësi duken se janë ato me më shumë anëtarë. Numri mesatar i pjesëtarëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike është 3.8. Rikujtojmë se numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve në këtë Bashki është 2.9.



Përqindja e popullsisë që përfiton ndihmën ekonomike është: Në Kukur 45% e popullsisë; Në Kodovjat dhe Lenie 43% e popullsisë; Në Pishaj, Sult dhe Poroçan 30% e popullsisë, në Gramsh, Skënderbegas dhe Kushovë 13% e popullsisë dhe në Tunjë 8.2% e popullsisë.

Karakteristikat kryesore të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike:

- 16% e familjeve përfituese kanë 2 apo më shumë se 2 fëmijë të mitur.
- 5,3% kanë gruan kryefamiljare.
- 18,4% e familjeve kanë të paktën një person me aftësi të kufizuara në familje;
- 4,4% kanë të paktën një pjesëtar në moshë pensjoni
- 0,4% e familjeve përfituese janë rome ose egjiptiane. Në fakt kjo përqindje është më e lartë, por jo çdo familje rome apo egjiptiane vetëdeklarohet si e tillë.

Fuqizimi ekonomik i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike është i lidhur drejtpërdrejtë me shërbimin e punësimit, prandaj është e rëndësishme që të vlerësojmë edhe karakteristikat e punëkërkesve në këtë Bashki.

Të dhënat e Zyrës së Punës së muajit prill 2020 për këtë Bashki japin 1,340 punëkërkes në këtë Bashki. 3,8% e popullsisë është aktualisht në kërkim të një pune. Rikujtojmë se 25% e popullsisë me moshë mbi 18 vjeç përfiton ndihmë ekonomike.

Në ligjin për asistencën sociale detyrimin për rregjistrim në Zyrën e Punës e kanë vetëm individët madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike që jetojnë në zonën urbane, gjë që shpjegon diferencën e madhe mes individëve që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe atyre që janë të rregjistruar në Zyrën e Punës. Siç shihet në tabelën 1, në zonën urbane të Bashkisë banojnë 86% e punëkërkesve dhe 14% e tyre banojnë në zonën rurale të saj.

Tabela 1: Të dhëna mbi papunësinë sipas karakteristikave të përgjithshme në nivel Bashkie

Bashkia	Grupmosha	Urban	Rural	Sipas gjinisë		Sipas statusit			
				Femra	Meshkuj	PAK	Romë/ Egjiptjane	Emigrate te kthyer	Gra kryefamijare
GRAMSH	16-19 vjec	11	9	13	7	-	4	-	2
	20-24 vjec	93	42	59	76	-	14	-	8
	25-29 vjec	89	26	46	69	-	6	-	10
	30-39 vjec	230	54	145	139	3	24	-	22
	40+	731	55	403	383	8	47	-	48
	Total	1154	186	666	674	11	95	-	90

Në kërkim të një pune janë si femrat (49,7% e punëkërkesve) edhe meshkujt (50,3 e punëkërkesve).

Karakteristikat kryesore të punëkërkesve:

- 7% e punëkërkesve janë romë/egjptianë.


- 6,7% e punëkërkuarve janë gra kryefamiljare. 72% e grave kryefamiljare që përfitojnë ndihmën ekonomike janë të rregjistruara në Zyrën e Punës në kërkim të një pune.
- 0,8% e punëkërkuarve janë me aftësi të kufizuara. Në këtë Bashki janë 1,201 persona me aftësi të kufizuara, pra vetëm 0.9% e tyre janë të rregjistruar në Zyrën e Punës.
- Grupmosha që e ka më të vështirë për të siguruar një punë është ajo mbi 40 vjeç. 59% e punëkërkuarve janë të kësaj grupmoshe. Ajo pasohet nga grupmosha 30-39 vjeç me 21% të punëkërkuarve të papunë.
- Mungesa e një profesioni duket se është një arsye për pamundësinë për të siguruar një punë në këtë Bashki. vetëm 16% e punëkërkuarve kanë arsim profesional ose universitar, që krijojnë mundësinë e një profesioni.
- Nuk ka ndryshime mes femrave dhe meshkujve në këndvështrimin e profesionit. Në secilën prej dy gjinive 83% kanë arsim deri në nivelin e mesëm të përgjithshëm.

2. Persona me aftësi të kufizuara

Sipas të dhënave të mujit prill 2020 të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashkisë Gramsh, në këtë Bashki 1,201 persona janë vlerësuar nga komisionet mjeksore me të paktën një formë të aftësisë së kufizuar. Referuar numrit të përgjithshëm të popullsisë 3,4% e popullsisë së kësaj Bashkie është përfshirë në programin e pagesave cash të aftësisë së kufizuar të financuar nga buxheti kombëtar.


Nga 1,201 persona me aftësi të kufizuar 234 (19%) kanë një formë shumë të rëndë të aftësisë së kufizuar e për pasojë kanë një ndihmës që kujdeset për ta. 79% e personave me aftësi të kufizuar kanë probleme të shëndetit fizik/mendor dhe ata përbëjnë grupin më të madh të aftësisë së kufizuar në këtë Bashki.

Siç shihet në grafikun 3 njësitë administrative Gramsh dhe Pishaj kanë numrin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara.



12% e personave me aftësi të kufizuara janë fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç. Nevojat e tyre për shërbime janë të ndryshme nga ato të personave madhorë. Në këto kushte është e nevojshme analiza e këtij grupi.

GRAFIK 4: FEMIJE ME AFTËSI TË KUFIZUARA




Referuar numrit të fëmijëve të grupmoshës 0-18 vjeç në Bashkinë Gramsh (8,487 fëmijë), konkludojmë se 1,7% e fëmijëve në këtë Bashki kanë një aftësi të kufizuar e për rrjedhojë kanë nevoja për shërbime specifike të kujdesit shoqëror.

32% e fëmijëve me AK jetojnë në territorin e njësisë

administrative Gramsh, 22% e tyre jetojnë në njësinë administrative Pishaj, në Kodovjat 14%, dhe në njësitë e tjera administrative jetojnë nga 2%-7% e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Invalidët e punës janë një tjetër grup që përveç pensionit të invaliditetit përfitojnë edhe një pagesë nga programi i mbrojtjes sociale. Janë 947 invalidë pune në Bashkinë Gramsh.

GRAFIK 5: INVALIDE PUNE




47% e invalidëve të punës jetojnë në njësinë administrative Gramsh, 19% e tyre jetojnë në njësinë administrative Pishaj. Në njësitë e tjera administrative i gjejmë në përqindje më të vogël.

3. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Sipas të dhënave të Punonjësës së Mbrojtjes së Fëmijës për Bashkinë Gramsh gjatë vitit 2019 janë rregjistruar e menaxhuar 46 raste të fëmijëve, specifikisht: 16 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, 10 raste të fëmijëve të dhunuar apo shfrytëzuar, 13 raste të fëmijëve pjesë e

familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, 2 fëmijë të vendosur në familje kujdestare dhe 5 raste të fëmijëve me status jetimi.

Raste të menaxhuara janë raportuar në vetëm katër nga 10 njësitë administrative në këtë Bashki. 54% e rasteve janë fëmijë që banojnë në territorin e njësisë administrative Gramsh; 22% në Pishaj, 20% në Kodovjat dhe 4% në Skënderbegas.



Problemi kryesor i raportuar në lidhje me fëmijët lidhet me nivelin e lartë të varfërisë. Në fakt siç u shpjegua edhe në seksionin mbi familjet përfituese të ndihmës ekonomike, pjesë e këtyre familjeve janë 2,552 fëmijë. Në kushtet që masa e ndihmës ekonomike është e ulët, familjet mund ta kenë të vështirë të adresojnë nevojat për mirëritjen e tyre. Kjo kërkon shërbime shtesë nga Bashkia për të mundësuar mbrojtjen dhe përkujdesjen ndaj tyre.

Në familjet rome dhe egjiptiane raportohen probleme me përfshirjen e fëmijëve në shkollë, mos ndjekjen e rregullt të mësimit dhe shfrytëzimin e tyre për punë.

141 fëmijë janë me aftësi të kufizuara. Nuk janë identifikuar raste të braktisjes apo abuzimit me fëmijë me aftësi të kufizuara, por këta fëmijë kanë të domosdoshme shërbime zhvilluese dhe rehabilituese që përmirësojnë jetesën e tyre brenda familjes dhe në komunitet.

4. Viktimat e dhunës në familje


Për të analizuar situatën e dhunës në familje në Bashkinë Gramsh u kërkuar të dhëna për vitet 2018 dhe 2019 nga strukturat e policisë, shëndetësisë, si dhe të vetë Bashkisë.

Strukturat e shëndetësisë nuk raportuan raste dhunë për asnjë nga dy vitet. Të dhënat e policisë dhe të strukturës së shërbimit social të Bashkisë konvergojnë për secilin prej viteve.

Në 2018 janë pajisur më urdhër mbrojtje/urdhër të menjëhershëm mbrojtjes 27 viktimë të dhunës në familje, ndërsa në 2019 janë 25 viktimë të dhunës në familje.

Në 75% të rasteve viktimë ka qenë grua, në 15% viktimë ka qenë burrë. 3.8% e rasteve të dhunës kanë sjellë për pasojë plagosjen e viktimës dhe në 2% të rasteve viktimë ka humbur jetën si pasojë e dhunës.

Raste dhune janë denoncuar në 7 nga 10 njësitë administrative të kësaj Bashkie. Në Lenie, Tunjë dhe Kushovë nuk janë raportuar raste dhune. Konsultimi me aktorët lokalë nxorri në pah faktin se mungesa e rasteve në këto njësi administrative nuk pasqyron realitetin, pasi dhuna ndodh brenda familjes, por ajo nuk raportohet për arsye të ndryshme: mentaliteti se çfarë ndodh në familje duhet të mbetet brenda



familjes; vështirësitë ekonomike, mungesat në strehim e bëjnë viktimën të ndihet e pasigurt për të ardhmen nëse dhunuesi dënohet; mungesa e besimit se denoncimi do të shoqërohet me shërbime që do të mbështesin fuqizimin e viktimës; mungesa e ndërgjegjësimit mbi pasojat e dhunës dhe domosdoshmërinë e denoncimit të saj. Në tërësi pjesëmarrësit në konsultime mendojnë se edhe në njësitë e tjera administrative numri i rasteve të dhunës është më i lartë, por për të njëjtat arsye si më lart rastet nuk denoncohen. Pjesëmarrësit sollën shembuj të viktimave të dhunës që bënin denoncimin dhe më pas tërhiqeshin në Gjykatë për shkak të pasigurisë ekonomike.

5. Në familje që kërkojnë mbështetje për strehim

Bashkia Gramsh aplikon forma të ndryshme të strehimit social për të adresuar nevojat për strehim të familjeve në territorin e saj. Kërkesat për strehim social në këtë Bashki janë të larta. 410 kërkesa janë rregjistruar për vitin 2020 për tu mundësuar banesa sociale, ndërsa numri i familjeve që kanë kërkuar mbështetje me bonus qeraje nga Bashkia ka ardhur duke u rritur ndër vite. Në vitin 2018 u përfshinë në këtë program 8 familje, në 2019 u përfshinë 42 familje dhe në vitin 2020 janë 63 familje që përfitojnë bonusin e qerasë.


6. Të moshuar në nevojë për shërbime

Të vetmet të dhëna që rregjistrohen nga strukturat e Bashkisë në lidhje me të moshuarit janë ato që lidhen me përfitimin e ndihmës ekonomike. Sikurse u prezantua në seksionin përkatës janë 104 të moshuar pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Mungojnë të dhëna statistikore të mbledhura në mënyrë të vazhdueshme mbi nevojat për shërbime për të moshuarit, gjë që e vështirëson të kuptuarin e nevojave për këtë target-grup.


Mungesa e identifikimit proaktiv të rasteve në nevojë për shërbime sjell për pasojë edhe mungesën e informimit të komunitetit se ku dhe si të kërkoj mbështetje, edhe identifikimin e rasteve nga vetë strukturat e Bashkisë.

7. Në familje që kanë përjetuar divorc

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile 66 raste divorcesh janë rregjistruar për vitin 2019 në Bashkinë Gramsh.



8. Përdorues të drogës, alkoolit




61 përdorues alkooli janë raportuar nga strukturat e Policisë dhe të Bashkisë për vitin 2020. Gramshi dhe Pishaj kanë përqindjen më të lartë të përdoruesve të alkoolit.

Nga konsultimi me strukturat e shërbimit social të Bashkisë u theksua se përdoruesit e drogës dhe alkoolit janë

rritur vitet e fundit.

37 përdorues droge janë identifikuar nga strukturat e policisë gjatë vitit 2019 dhe ndër vite numri i përdoruesve ka ardhur duke u rritur. Rastet i përkasin vetëm katër njësitë administrative. Siç shihet në grafikun 14 në njësinë administrative Gramsh janë identifikuar 59% e rasteve.



2.2.2. Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve

Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme

Mundësia e gjenerimit të të ardhurave nga individët madhorë të këtyre familjeve është e limituar si në zonën urbane edhe në zonën urbane të Bashkisë. Numri i kufizuar i bizneseve dhe natyra e tyre (biznese të vogla dhe kryesisht familjare) ulin mundësitë e ofertave të punës nga Zyra e Punës në Gramsh.

Zyra e Punës në Gramsh këshillon e ndërmjetëson për punësim dhe trajton me prioritet individët në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Çdo vit kjo Zyrë ka aplikuar skema të nxitjes së punësimit dhe për këtë vit parashikohet që nga kjo skemë të përfitojnë 62 individë. Sfidat me punësimin e pjesëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike janë dy: (1) mundësitë e kufizuara për punësim në territorin e Bashkisë; (2) refuzim i ofertave të punës nga pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, të cilët në një masë të konsiderueshme preferojnë të punojnë në të zezë në mënyrë që të vijojnë të përfitojnë ndihmën ekonomike. Edhe pse ka një mekanizëm të ngritur për rastet e refuzimit, punonjësit e Zyrës së Punës përgjithësisht nuk aplikojnë largimin nga skema për shkak të refuzimit të ofertës së punës.

Kurset e formimit profesional janë të orientuara sipas kërkesave të punëkërkuësve, por dhe të karakteristikave të tregut të punës në këtë Bashki. Në Gramsh zhvillohen kurse për elektrikist, parukierë, guzhinë, ndërsa për ndjekjen e kurseve të tjera ndërveprohet me Tiranën, Durrësin apo Elbasanin. Më së fundi është ngritur kursi për bletërritës mbi bazën e kërkesave që kanë

ardhur nga punëkërkesit. Megjithatë, edhe pse kurset ofrohen sipas karakteristikave të tregut të punës mbetet i vështirë punësimi pas përfundimit të kursit.

Ngritja e bizneseve të reja, siç është fabrika e peshkut që pritet të fillojë punën, është një mundësi për rritjen e punësimit.

Shërbime për personat me aftësi të kufizuara

Me mbështetjen e USAID dhe Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Bashkia Gramsh hartoi dhe miratoi në vitin 2019 “Planin Lokal për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Gramsh”. Plani ka mundësuar një vlerësim të gjerë të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara në këtë Bashki dhe ka përcaktuar drejtimet kryesore të ndërhyrjes për (i) shërbime të kujdesit shoqëror dhe shëndetësor; (ii) arsimit; (iii) punësimi dhe formimi profesional; (iv) aksesueshmëria fizike dhe në transport; (v) barazia; (vi) pjesëmarrja në jetën publike dhe politike. Në përputhje me këtë Plan “Banorët e Bashkisë Gramsh me aftësi të kufizuara, përballen me shumë pengesa në përpjekjet e tyre për t’u përfshirë në jetën social - ekonomike, politike e kulturore të vendit. Vështirësitë, ndër të tjera, kanë të bëjnë me: (a) mungesën e aksesueshmërisë, e për pasojë, përfshirja e pjesëmarrjes së tyre është në nivele të ulëta në të gjitha sferat e jetës; (b) nivelin e ulët të të ardhurave; (c) mungesën e shërbimeve të lidhura me rehabilitimin e integrimin; (d) mungesën e shërbimeve në komunitetet ku ata jetojnë; (e) mungesën e përfshirjes së tyre në sistemin arsimor të të gjithë niveleve në sistemin e punësimit dhe formimit profesional; (f) diskriminimin, stigmatizimin e paragjykimet.¹⁶” Ky Plan është multisektorial dhe gjithëpërfshirës, si dhe ka parashikuar masa që duhet të merren jo vetëm nga Bashkia, por edhe institucione të tjera lokale (Arsimi, shëndetësia, Zyrat e Punës etj) për të përmirësuar situatën e personave me aftësi të kufizuara në këtë Bashki. Plani është i miratuar dhe çdo institucion është angazhuar për të përmbushur masat e parashikuara në të.

Në këndvështrimin e Planit Social lokal në fokus janë shërbimet egzistuese të kujdesit shoqëror që adresojnë nevojat e këtij grupi për shërbime. Sipas Planit të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, por edhe konsultimeve të zhvilluara me përfaqësues të institucioneve lokale dhe intervistat me vetë persona me aftësi të kufizuara, konkludojmë se shërbimet e egzistuese janë të pamjaftueshme për të adresuar nevojat e këtij grupi për zhvillim, reabilitim apo riintegrim ekonomik e social.

¹⁶ Plan Lokal për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Gramsh, fq. 6

Shërbimet egzistuese dhe sfidat aktuale:

Qendra ditore “Lule Djelli” është shërbim publik i kujdesit shoqëror për fëmijët me aftësi të kufizuara që financohet nga Qarku Elbasan dhe Bashkia Gramsh. Në qendër marrin shërbim 15 fëmijë nga mosha 6-18 vjeç, nga të cilët 10 meshkuj dhe 5 femra, me diagnoza kryesisht paraplegji, probleme të komunikimit dhe me ndërthurje aftësi të kufizuara fizike dhe mendore. Ky shërbim synon të mbështesë fëmijët në procesin e integritit social dhe zhvillimin e funksionimit psiko-edukativ të tyre. Për shkak të mungesave në buxhet kapacitet e stafit të qendrës raportohen të jenë të pamjaftueshme. Mungon pozicioni i logopedistit dhe i sanitares. Referuar numrit të përgjithshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara në këtë Bashki (141 fëmijë) vetëm 10,6% e tyre përfitojnë shërbime kujdesi shoqëror. Në zonën rurale edhe ky shërbim është tërësisht i munguar.

Për personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç mungon çdo lloj forme shërbimi kujdesi shoqëror. Nuk u raportuan raste të braktisjes së personave me aftësi të kufizuara nga familjarët e tyre.

Shërbimi shëndetësor është gjithashtu një nevojë prioritare për këtë grup. Strukturat shëndetësore në këtë Bashki raportojnë 10 qendra shëndetësore, 1 spital rajonal dhe Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor. Kjo e fundit trajton rreth 60 raste në vit dhe në total trajtohen përmes shërbimeve të qendrës 1050 persona me probleme të shëndetit mendor. Qendra ofron shërbimet: vizitë tek mjeku specialist; këshillim psiko-social si dhe psiko-terapi e klientëve; këshillim psiko-social i familjareve dhe avokatia e klientëve; shërbim shëndetësor në shtëpi nga stafi multidisiplinar i qendrës, i cili trajton rreth 60 raste në vit, ndërkohë që në qendër trajtohen rreth 1050 klientë.

Mungesa e mjekëve specialistë është një sfidë për sistemin shëndetësor në Bashkinë Gramsh. Në mënyrë të veçantë mungojnë neurologët dhe psikiatrit, gjë që i detyron personat me aftësi të kufizuara ti drejtohen Elbasanit apo

“10 vjet më parë më vdiq bashkëshorti. Jetoj me djalin 27 vjeç, të papunë dhe djalin 15 vjeçar me aftësi të kufizuara. Djali 27 vjeçar nuk ka mundur të gjej një punë, sepse nuk ka profesion dhe as ka kryer ndonjë kurs për të marrë profesion. Kujdesem për djalin 15 vjeçar dhe të tre jetojmë me pagesën që i jep shteti dhe me ndihmën ekonomike. Me vështirësi e përballoj jetesën. Djali për shkak të prapambetjes mendore nuk ka shkuar kurrë në shkollë, por shkon në qendrën ditore. Kam shumë vështirësi në kujdesin për të në shtëpi, pasi merr ushqim në mënyrë të pakontrolluar. Nuk di si ta ndihmoj”.

Rudi, 50 vjeç

Tiranës për të marrë shërbimin e duhur nga mjekët specialistë¹⁷.

Në lidhje me arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara theksojmë egzistencën e mësuesve ndihmës, megjithatë ata duhet të jenë numërikisht më shumë, sikurse është i nevojshëm trainimi në vazhdim i tyre¹⁸.

Siç theksuam kur trajtuam çështjet e punësimit, vetëm 11 persona me aftësi të kufizuara rezultojnë të rregjistruar për punë pranë Zyrës së Punës. Pra vetëm 1% e personave me aftësi të kufizuara që nuk kanë një diagnozë të rëndë janë në kërkim të një pune. Arsyet lidhen sa me mungesën e ofertave të punës aq edhe me mungesën e ndërjegjësimin të vetë personave me aftësi të kufizuara për nevojën për tu përfshirë në tregun e punës pa humbur benefitet e skemës së mbrojtjes sociale¹⁹.

Shërbime për fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Identifikimi dhe menaxhimi rastit:

Edhe pse në Bashkinë Gramsh ka vetëm një Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijës që mbulon të gjithë territorin, është ndërtuar një praktikë pune që përfshin:

- Identifikimi i rastit kryhet nga vizita në terren, si dhe referime të institucioneve të tjera.
- Administratorët shoqëror në çdo njësi administrative kanë pjesë të punës së tyre edhe identifikimin dhe referimin tek PMF të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.
- Kryetarët e fshatrave janë gjithashtu të përfshirë në këtë praktikë pune duke referuar raste të tilla tek PMF.

Për menaxhimin e rastit punonjësja e mbrojtjes së fëmijës thërret grupin Teknik ndërsektorial duke përfshirë përfaqësues institucionesh apo shërbimesh në përputhje me karakteristikat e rastit dhe nevojat individuale të fëmijës në rrezik.

¹⁷ Për më shumë referoju Plan Lokal për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Gramsh, Vlerësimi i gjendjes të shërbimeve shëndetësore fq. 14

¹⁸ Për më shumë referoju Plan Lokal për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Gramsh, Vlerësimi i gjendjes në fushën e arsimit fq. 24

¹⁹ Për më shumë referoju Plan Lokal për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Gramsh, Vlerësimi i gjendjes në fushën e punësimit dhe formimit profesional, faqe 34

Punonjësja e mbrojtjes së fëmijës bashkëpunon vazhdimisht me shkollat në teritorin e Bashkisë dhe ka kryer sistematikisht takime me fëmijët dhe personelin arsimor për të ndërgjegjësuar mbi çështje specifike që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Nuk janë zhvilluar takime në komunitet në lidhje me këto çështje.

Ky lloj mekanizmi është ngritur gradualisht dhe tashmë çdo institucion ka qartësi për rolin dhe përgjegjësinë që ka si pjesë e mekanizmit lokal për të ndërgjegjësuar mbi të drejtat e fëmijës, për ti mbrojtur e përkujdesur fëmijët e rrezikuar.

Shërbimet e kujdesit shoqëror

Stafit të shërbimit social të Bashkisë i është dashur të menaxhojë raste emergjente, raste të fëmijëve pa kujdes prindëror të përkohshëm. Në Bashkinë Gramsh nuk ka një regjistër të familjeve kujdestare, për rrjedhojë rastet janë menaxhuar duke kërkuar së pari zgjidhje për akomodimin dhe jetesën e përkohëshme të fëmijëve pranë të afërmeve të tyre. Kur kjo ka qenë e mundur Bashkia ka kryer procedurat e marrjes së shërbimit të kujdestarisë nga familja kujdestare pranë Gjykatës. Kur nuk ka qenë i mundur akomodimi pranë të afërmeve të fëmijës zgjidhja është gjendur përmes shërbimit rezidencial. Raste të tilla kanë ndodhur kryesisht kur prindërit/prindi i fëmijës nuk ka pranuar që zgjidhja të gjendej përmes familjes kujdestare.

Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve punonjësja e mbrojtjes së fëmijës ka referuar rastet pranë shërbimeve rezidenciale në nivel kombëtar përmes bashkëpunimit me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Qarku Elbasan, apo referimit në qendrën “Tjetër Vizion”.

Për shërbimet ligjore falas stafi social mbështetet në bashkëpunimin e ndërtuar tashmë me organizatën “TLAS”.

Shërbime të tjera

Çerdhet, kopshtet dhe shkollat nuk janë shërbime të kujdesit shoqëror, por ato lidhen drejtpërdrejtë me nevojat e fëmijëve dhe të familjeve të tyre, veçanërisht familjeve në vështirësi ekonomike. Shpesh mungesa e çerdheve apo kopshteve bëhet një faktor që nëna të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike të mos pranojnë ofertat e punës dhe të vijnë në përballen me sfidat e varfërisë. Ndërkohë sistemi arsimor është pjesë e rëndësishme e mekanizmit lokal të mbrojtjes së fëmijës.

Në Bashkinë Gramsh ka vetëm një çerdhe ku marrin shërbim 23 fëmijë nga katër edukatore. Janë 61 kopshte ku janë të përfshirë 692 fëmijë, për të cilët kujdesen 62 edukatore. Bashkia

ndjek politika lehtësuese ndaj familjeve me të ardhura të pamjaftueshme me qëllim mundësimin e aksesit të fëmijëve në çerdhe dhe kopshte.

Janë 17 shkolla 9 vjeçare, ku marrin mësim 2,326 fëmijë. Janë shënuar raste të braktisjes së shkollës nga fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian. Në 9 shkollat e mesme marrin mësim 762 nxënës. Shërbimi psikologjik në shkolla është i pamjaftueshëm. Janë vetëm dy psikolog për 26 shkolla me një ngarkesë pune një psikolog për 1,544 fëmijë.

Shërbime për viktimat e dhunës në familje

Identifikimi dhe menaxhimi rastit:

Bashkia përmes bashkëpunimit me “Forum in e Pavarur të Gruas Elbasan” ka tashmë një koordinator vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje. Mekanizmi lokal për menaxhimin e rasteve të dhunës është ngritur. Bashkia dhe Policia ndërveprojnë vazhdimisht për çdo rast të denoncuar dhune. Strukturat e policisë janë të angazhuara për identifikimin e rasteve përmes mekanizmit të policimit në komunitet. Nuk u raportuan raste që dhuna të jetë referuar nga insitucione të tjera. Çdo rast është denoncuar nga vetë viktimat në Polici dhe më pas kjo e fundit ka njoftuar strukturën përgjegjëse në Bashki me qëllim ofrimin e shërbimeve të tjera sociale viktimës së dhunës.

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki ka planifikuar takime komunitare në fshatra me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit vendor mbi dhunën në familje.

Shërbimet e kujdesit shoqëror

Koordinatori për masa kundër dhunës në familje ofron edhe shërbimin psikologjik të menjëhershëm për viktimat e dhunës të referuara. Përmes partneritetit të ngritur me Forum in e Pavarur të Gruas Elbasan viktimave të dhunës në familje u ofrohet gjithashtu këshillim ligjor.

“Jetoj me bashkëshortin dhe dy fëmijët tanë 5 dhe 2 vjeç. Prej një viti kam urdhër mbrojtje për shkak të dhunës së ushtruar ndaj meje nga nëna ime. Edhe pse me urdhër mbrojtje vijoj të ndihem e kërcënuar prej saj. Nëna nuk ka marrë shërbim psikologjik edhe pse punonjësja e Bashkisë është përjekur disa herë të punoj me të. Gjykata nuk e ka vendosur si masë ndaj saj marrjen e këtij lloji shërbimi. Gjatë gjithë kohës punonjësja e Bashkisë më ka mbështetur me këshillim psikologjik, por edhe me paketa ushqimore, pasi kushtet ekonomike i kemi të vështira. Unë kam mbaruar shkollën për infermiere, por jam pa punë. Bashkëshorti punon më shumë në emigracion”.

Iva, 27 vjeç

Në rastet e emergjencës që paraqesin rrezik mundësohet akomodimi për 5 ditë në ambjentin e emergjencës të ngritur nga ky Forum në Elbasan.

Shërbimi i strehimit social

Struktura përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit mbi strehimin social në Bashkinë Gramsh është Drejtoria e shërbimeve publike.

Prej tre vitesh kjo Bashki aplikon bonusin e qerasë si një mundësi për të adresuar nevojat për strehim të familjeve me të ardhura të pamjaftueshme. Problematike ka qenë deri para pak vitesh pamundësia e sigurimit të kontratës me qeradhënësit nga familjet që përfitonin nga programi i bonusit të qerasë. Me një vendim të Këshillit Bashkiak Gramsh ky problem është kapërcyer tashmë.

Ndërkohë Bashkia është duke ndërtuar banesa sociale, por pamundësia financiare vështirëson përfshirjen në këtë program të familjeve pa të ardhura.

9 familje rrome do përfitojnë rikonstruksion banese përmes financimit nga Ministria e linjës. Mungesa e çertifikatës së pronësisë ka penguar familje të tjera në të njëjtat kushte me këto familje për të përfituar nga kjo formë financimi..

Bashkia gjithashtu ka venë në dispozicion truallin dhe biznese lokale po ndërtojnë tre banesa për familje pa të ardhura.

63 familje përfitojnë gjatë vitit 2020 bonusin e qerasë, ndërkohë që 20 familje kanë përfituar kredi të butë.

Shërbime për të moshuarit

Një nga asetet e Bashkisë i është vënë në dispozicion Kryqit të Kuq, i cili ka krijuar një ambjent për të moshuarit. Ky ambjent krijon mundësinë e kalimit të kohës së lirë të të moshuarve, por nuk ka karakteristikat e një shërbimi ditor për të moshuarit.

Shërbime për familjet që kanë përjetuar divorc

Nuk u identifikua asnjë formë shërbimi që mund të adresonte nevojat e këtij grupi.

Përdorues të drogës, alkoolit

Nuk u identifikua asnjë formë shërbimi që mund të adresonte nevojat e këtij grupi.

2.2.3. Mangësitë - nevojat e paplotësuara

10,440 individë ose 30% e popullsisë së Bashkisë Gramsh u identifikua në nevojë për të paktën një formë shërbimi kujdesi shoqëror. Pëshën kryesore në këtë numër e mbajnë individët pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara. Bashkia duhet të zhvillojë me prioritet programe që nxisin fuqizimin ekonomik të këtyre familjeve, sikurse të zhvillojë forma shërbimesh kujdesi shoqëror sipas nevojave specifike të çdo grupi të identifikuar. Kundrejt kësaj nevojë të lartë për shërbime në Bashkinë Gramsh është funksional vetëm një qendër ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Bashkia ka ndërtuar partneritetin me një ofrues jo publik shërbimi duke adresuar një pjesë të nevojave të viktimave të dhunës në familje.

Mangësitë e identikuara i përkasin dy drejtimeve kryesore: (i) në burime njerëzore dhe kapacitete të Bashkisë për të ngritur dhe bërë funksional sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror; (ii) në shërbime të kujdesit shoqëror të vlerësuara mbi bazën e nevojave të individëve të identifikuar që duhet ti marrin këto shërbime.

2.2.3.1. Mangësitë në burime njerëzore dhe kapacitete të Bashkisë

Në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Gramsh të miratuar në 26 Mars 2012, struktura përgjegjëse për mbrojtjen dhe kujdesin social në këtë Bashki është Sektori i ndihmës dhe shërbimit social. Ky sektor është pjesë e Drejtorisë Ekonomike²⁰.

Sektori përmbush detyra që lidhen si me administrimin e programit të pagesave cash, ashtu edhe me vlerësimin e nevojave të individëve për shërbime dhe kryerjen e procedurave për ofrimin e tyre.

Rregullorja e Brendshme është miratuar 8 vjet më parë dhe në të nuk janë reflektuar ndryshimet ligjore që kanë ndodhur e që i kanë dhënë role dhe përgjegjësi të reja Bashkive.

²⁰ Në përputhje me nenet 72, 72/1, 72/2, 72/3 të Rregullores së Bashkisë Nr. 556/2 prot, datë 26.03.2012

Në mënyrë të veçantë në rolet dhe përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për mbrojtjen dhe kujdesin social mungojnë:

- Parashikimet ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror,
- Detyrat funksionale për programin e pagesave cash (ndihma ekonomike dhe PAK) nuk i përgjigjen ndryshimeve në legjislacionin për asistencën sociale,
- Mungojnë tërësisht detyrat në lidhje me mbrojtjen dhe përkujdesjen për fëmijët,
- Mungojnë rolet dhe përgjegjësinë që rrjedhin nga ligji për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.

Megjithatë personeli i sektorit të ndihmës dhe shërbimit social, pavarësisht mangësive në përshkrimet e punës në Rregulloren e Bashkisë përmbush me burimet dhe kapacitetet që ka në dispozicion detyra që rrjedhin nga ligjet e sipërcituara.

Spektori i ndihmës dhe shërbimit social përbëhet nga:

Përgjegjës sektori (1)- përgjigjet për drejtimin dhe koordinimin e punës së të gjithë ekipit, si dhe administron programin e pagesave të aftësisë së kufizuar për njësinë administrative Gramsh.

Specialiste e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje, si dhe Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës (1) – Përmbush në praktikë detyra që rrjedhin nga tre ligje: barazi gjinore, masa kundër dhunës dhe të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Specialist i administrimit të ndihmës ekonomike dhe shërbimit social (1) – përmbush detyra që lidhen me aplikimin për ndihmë ekonomike të familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme për njësinë administrative Gramsh.

Administratorë shoqëror (9) – përmbushin detyra që lidhen me programin e mbrojtjes sociale (ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar) për territorin e njësisive administrative, specifikisht: Kushovë (1), Pishaj (1- punonjës social në profesion), Poroçan (1), Sult (1), Tunjë (1), Skënderbegas (1), Lenie (1), Kodovjat (1), Kukur (1).

Nga intervistat dhe konsultimet e zhvilluara personeli i shërbimit social raporton si sfida kryesore: (i) niveli shumë i lartë i varfërisë dhe mungesa e shërbimeve që i pengon në menaxhimin e rasteve sociale; (ii) vështirësi infrastrukturore për identifikimin proaktiv të rasteve si rezultat i shtrirjes së gjerë gjeografike që ka Bashkia, (iii) mungesa në buxhet për menaxhimin e rasteve sociale; (iv) mungesë në burime njerëzore, veçanërisht punonjës social që të menaxhojnë profesionalisht rastet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

2.2.3.2. Mangësitë në shërbime të kujdesit shoqëror

○ Për 6,334 individët në moshë pune të familjeve përfituese të :

Në kushtet që numri i individëve në skemën e ndihmës ekonomike është i lartë si në zonën urbane ashtu edhe në atë rurale, si dhe të faktit që ndihma ekonomike është një mekanizëm i përkohshëm dhe i pamjaftueshëm për të adresuar nevojat e tyre, Bashkia në ndërveprim me partnerë publik dhe jo publik lokalë e rajonalë duhet të ndërmarrë masa që mundësojnë fuqizimin ekonomik dhe riintegrim social të tyre. Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit duhet të punojnë në partneritet me specialistët e Zyrës së Punës për të ndërgjegjësuar çdo individ në vështirësi ekonomike mbi domosdoshmërinë e pranimit të ofertës së punës dhe shmangien e punës në të zezë. Përveç masave për nxitjen e punësimit, të tilla si mbështetje e bizneseve që punësojnë individë nga familje me ndihmë ekonomike apo persona me aftësi të kufizuara, kurse formimi profesionale, oferta pune të përshtatëshme për karakteristikat e çdo individi të ndërmarrë nga Zyra e Punës, Bashkia duhet të ndërtoj partneritetin me organizata joqeveritare me qëllim ngritjen e bizneseve sociale duke shfrytëzuar hapësirat që lindin nga Ligji “Për ndërmarrjet sociale” dhe mekanizmat egzistues për financimin e këtyre sipërmarrjeve.

○ Për 1,060 persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç dhe 947 invalidë pune:

Bashkia Gramsh ka një Plan të detajuar për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, zbatimi i të cilit nga secili prej institucioneve publike lokale është tejet i rëndësishëm për të ëprmirësuar situatën e personave me aftësi të kufizuara në këtë Bashki. Në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për periudhën tre vjeçare të zbatimit të Planit Social duhen prioritetizuar:

(1) Praktika e këshillimit për punësim, si dhe këshillimit social në përgjithësi për personat me aftësi të kufizuara. E rëndësishme është nxitja e ndërgjegjësimit si të personave me AK ashtu edhe e punëdhënësve për punësimin e tyre.

(2) Modelim i bizneseve sociale që mundësojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

(3) Janë të nevojshme shërbime rehabilituese për personat në nevojë për aftësim fizik dhe psikosocial;

(4) Shërbimet në familje për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare dhe që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal duhet të mundësohen të kombinuara me shërbimet në qendra komunitare;

○ ***Për 2,726 fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje :***

(1) Mekanizmi lokal i ngritur duhet të ndërmarrë fushata informimi e ndërgjegjësimi edhe në komunitet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, veçanërisht në zonat më të thella të Bashkisë.

(2) Shërbimi i këshillimit me telefon. Ky shërbim është kombëtar dhe Bashkia do të ndërtoj partneritetin me Linjën Kombëtare me qëllim që linja telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, të ofroj mbështetje, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo përkujdesje;

(3) Shërbim psikologjik e kurse prindërimi për familjet biologjike, por edhe familjet e mundshme kujdestare. Një shërbim i tillë do të mundësojë jo vetëm adresimin e nevojave për këshillim psikologjik për fëmijë e familje, por hedh bazat për ngritjen e shërbimit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, i cili do të zhvillohet më tej pas përfundimit të periudhës tre vjeçare të këtij Plani.

(4) Qendër ditore dhe shërbim i emergjencës për rastet e fëmijëve të dhunuar, shfrytëzuar ose pa kujdes prindëror.

(5) Qendra ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara do të vijoj aktivitetin e saj, duke e zgjeruar edhe me shërbimin në familje për çdo grupmoshë të aftësisë së kufizuar.

○ ***Për të paktën 150 viktimë të dhunës në familje janë të nevojshme:***

(1) Mekanizmi lokal (i drejtuar nga Bashkia) do të ndërmarrë fushata informimi e ndërgjegjësimi në komunitet, veçanërisht në zonat më të thella të Bashkisë ku dhunë ka, por nuk raportohet.

(2) Shërbimi i këshillimit me telefon. Ky shërbim është kombëtar dhe Bashkia do të ndërtoj partneritetin me Linjën Kombëtare me qëllim që linja telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, të ofroj mbështetje, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;

(3) Shërbimi i strehimit të mbrojtur/strehim social për viktimat e dhunës në familje, (dhe viktimave të trafikimit nëse do të ketë të tilla) të cilët nuk kanë një strehë.

(4) Programet për fuqizimin ekonomik, pjesë e Planit Social, do të targetojnë edhe viktimat e dhunës në familje.

○ ***Për të paktën 410 individë me nevoja të vlerësuara për strehim social:***

(1) Bonusi i qerasë, do të mundësohet me prioritet për familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme (kryesisht ato përfituese të ndihmës ekonomike), familje me nënat kryefamiljare, familjej rome/egjiptiane, familje që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, familje me të moshuar në situatë të vështirë ekonomike dhe që jetojnë vetëm, viktimat të dhunës në familje, familje me fëmijë të mitur.

(2) Në partneritet me Ministrinë e linjës dhe komunitetin e biznesit Bashkia do të vijoj të mundësoj rikonstruksione të banesës për familje rome dhe të grupeve të tjera të identifikuara në nevojë që kanë një banesë tërësisht të amortizuar.

○ ***Për të paktën 104 të moshuar:***

(1) Shërbim në familje për të moshuar që jetojnë në situatë të vështirë ekonomike, nuk kujdesen dot për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal.

○ ***Për të paktën 120 pjesëtarë të familjeve që përjetojnë divorc:***

Shërbim psikosocial dhe shërbime të tjera mbështetëse e fuqizuese sipas nevojave të identifikuara.

○ ***Për të paktën 97 përdorues të drogës dhe alkoolit***

Shërbimi i rehabilitimit për personat me varësi nga droga/alkooli. Ky shërbim do të ngrihet gradualisht. Në vitin e parë do të ofrohet kryesisht shërbim psikologjik (terapi individuale dhe

në grup). Në partneritet me shërbimin shëndetësor më pas do të zgjerohet për të ofruar terapi më të specializuara që mundësojnë rintegrim.

2.2.4. Analiza SWOT

Pikat e forta

1. *Motivimi për të ngritur sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror*
2. *Aftësia për të thithur fonde nga donatorët*

Pikat e dobëta

1. *Mungesa në financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror*
2. *Personel i limituar për çështjet e shërbimeve sociale*
3. *Mungesa në infrastrukturë dhe çdo formë shërbimi kujdesi shoqëror*

Mundësitë

1. *Kuadri ligjor*
2. *Partneriteti i ngritur me ofrues shërbimesh*
3. *Eksperienca dhe praktika të ngjashme*

Rreziqet

1. *Vështirësi në ngritjen e Fondit Social*
2. *Kërkesa për shërbime e lartë*

Pikat e forta

1. *Motivimi për të ngritur sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror*

Adresimi i nevojave të grupeve vunerabël është prioritet për Bashkinë e Gramshit. Liderhipi i kësaj Bashkie dhe personeli i strukturës përgjegjëse aktuale për shërbimet sociale në Bashki dhe në njësitë administrative kanë vullnetin, motivimin dhe qartësinë e plotë për të ngritur dhe bërë funksional sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki.

2. *Aftësia për të thithur fonde nga donatorët*

Bashkia ka një njësi që punon për thithjen e fondeve nga donatorët dhe ka ekspertizën e duhur në formulimin e projekteve. Ndërkohë struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror ka demonstruar se ka kapacitetin e nevojshëm për të ngritur dhe zhvilluar partneritete në funksion të adresimit të nevojave të grupeve vulnerabël. Tregues është partneriteti jo vetëm me institucione jo publike në territorin e Bashkisë, por edhe me organizata joqeveritare që përmes projekteve të mbështetura nga donatorët po adresojnë përmes shërbimeve nevojat e disa prej grupeve vulnerabël në territorin e Bashkisë.

Pikat e dobëta

1. Mungesa në financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror

Bashkia Gramsh financon aktualisht vetëm një shërbim kujdesi shoqëror dhe nuk ka parashikuar për vitet në vijim fonde për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të tjera të nevojshme. Nuk janë parashikuar fonde as për menaxhimin e rasteve sociale, duke vështirësuar punën e ekipeve sociale.

2. Personel i limituar për çështjet e shërbimeve sociale

Analiza mbi burimet njerëzore tregoi se Bashkia nuk ka mjaftueshëm personel për të përmbushur detyrimet ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Mungojnë punonjësit socialë, ndërsa nuk është i mjaftueshëm personeli për menaxhimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijës.

3. Mungesa në infrastrukturë dhe çdo formë shërbimi kujdesi shoqëror

Ambjentet e punës së personelit nuk janë të përshtatura për specifikat e punës me individë në nevojë për shërbime, veçanërisht për nevoja të punës me fëmijët apo viktimat të dhunës në familje. Lëvizja nëpër fshatra për menaxhimin e rasteve është shumë e vështirë. Distancat janë të largëta dhe vështirësia rritet sidomos në orët e vona kur mungon çdo formë transporti. Nuk ka buxhet të dedikuar për menaxhimin e rasteve, kostot përballohen nga vetë punonjësit. Mungesa e shërbimeve në territorin e Bashkivë vështirëson mundësinë e menaxhimit cilësor të rasteve.

Mundësitë

1. Kuadri ligjor

Aktet nënligjore të Ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” kanë përcaktuar qartësisht sistemin e rregullave për ngritjen e shërbimeve komunitare për grupet në nevojë, për mekanizmin e financimit të shërbimeve, sikurse edhe për burimet njerëzore që duhet të egzistojnë në funksion të këtij sistemi. Për shërbimet e kujdesit shoqëror egzistojnë standarte kombëtare të miratura që janë baza mbi të cilën do të ngrihen tipet e shërbimeve që përmban Planit Social.

2. Partneriteti i ngritur me ofrues shërbimesh

Bashkia ka partneritet të ngritur gjithashtu me organizata në nivelin e qarkut që kanë shprehur angazhim për tu përfshirë në procesin e zbatimit të Planit Social.

3. Eksperienca dhe praktika të ngjashme

Në Qarkun Elbasan dhe Tiranë, që janë gjeografikisht pranë Bashkisë Gramsh ka të ngritura disa tipe shërbimesh të kujdesit shoqëror, që mund të shërbejnë si model praktik për stafin e shërbimit social të Bashkisë.

Rreziqet

1. Vështirësi në ngritjen e Fondit Social

Bashkia nuk ka parashikuar në buxhetin tre vjeçar të saj fonde për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Bashkisë do ti duhet të alokoj fonde nga të ardhurat e saj, të kërkoj mbështetje financiare nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, sikurse të ndërtojë punën me donatorë të ndryshëm me qëllim financimin e komponentëve të këtij Plani. Hartimi dhe miratimi i Planit disa muaj përpara nisjes së zbatimit të tij i jep kohë këtyre strukturave për të ngritur fondet e nevojshme për vitin e parë të zbatimit të tij.

2. Kërkesa për shërbime e lartë

Ka një numër të lartë individësh të identifikuar në nevojë për shërbime në territorin e Bashkisë dhe kundrejt tyre një mungesë të theksuar të shërbimeve që adresojnë nevojat e tyre. Duke mbajtur në konsideratë burimet shumë të kufizuara të Bashkisë mund të ndodhë që ngritja e shportës së shërbimeve të kërkojë më shumë kohë se sa periudha e zbatimit të këtij Plani.

3. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Për të mundësuar përmbushjen e Vizionit dhe Misionit në Planin e Veprimit për periudhën 2021-2023 janë parashikuar ndërhyrje në tre drejtime kryesore:

1. Krijimi i kushteve të nevojshme për ngritjen e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Analiza për organizimin dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse të mbrojtjes dhe kujdesit social në Bashki tregoi se ka mungesa në burime njerëzore, sikurse duhen rishikuar përshkrimet e punës me qëllim jo thjesht përmbushjen e detyrimeve ligjore, por mbi të gjitha mundësimin e shërbimit më të mirë ndaj grupeve vulnerabël në këtë Bashki. Masat e parashikuara përfshijnë plotësimin e strukturave me burimet e duhura njerëzore, ngritjen e kapaciteteve të tyre, përmirësimet e nevojshme në infrastrukturë dhe në buxhet në mënyrë që ato të arrijnë të planifikojmë e ngrenë shërbimet komunitare, sikurse të identifikojnë, të menaxhojnë e referojnë individët në nevojë tek këto shërbime.

2. Fuqizim ekonomik për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Masat në këtë këndvështrim janë të domosdoshme në kushtet e një numri të lartë të familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike në këtë Bashki, si dhe mungesës së dinamikës në skemën e ndihmës ekonomike e lidhur drejtpërdrejtë me mungesën e alternativave të punësimit, por edhe (në një masë më të vogël) të refuzimit të ofertave të punës nga pjestarë të këtyre familjeve.

3. Ofrim i shërbimeve sipas nevojave përmes sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Në kushtet që analiza e kryer tregoi që Bashkia nuk ka kapacitetet e duhura financiare për të përballuar ngritjen e çdo forme shërbimi kujdesi shoqëror, janë parashikuar të ngrihen në harkun e tre viteve dhe në mënyrë graduale format më prioritare të shërbimeve që adresojnë kryesisht nevojat e fëmijëve, viktimave të dhunës në familje, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve të vetmuar, familjeve në vështirësi ekonomike në nevojë për strehim, përdoruesve të drogës dhe alkoolit.

LLOGJIKA E PLANIT TE VEPRIMIT

1. Krijimi i kushteve të nevojshme për ngritjen e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror

- Rishikim i strukturës, roleve dhe funksioneve të Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social në Bashki
- Trainime dhe vizita studimore
- Infrastruktura dhe buxheti
- Ngritja e shërbimeve
- Menaxhimi dhe referimi i rasteve tek shërbimet

2. Fuqizim ekonomik për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme

- Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit lokal për nxitjen e fuqizimit ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe grupeve në nevojë
- Këshillimi për punësim dhe ofertat e punës
- Program i Bashkisë për fuqizimin ekonomik

3. Ofrim i shërbimeve sipas nevojave përmes sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

- Shërbimi i këshillimit me telefon për fëmijët
- Qendër ditore dhe shërbim i emergjencës për rastet e fëmijëve të dhunuar, shfrytëzuar ose pa kujdes prindëror
- Qendër ditore dhe shërbim në familje për fëmijë me aftësi të kufizuara
- Shërbimi i këshillimit me telefon për viktimat e dhunës në familje
- Shërbimi i strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje
- Qendër ditore multifunksionale (PAK, të moshuarit, shërbim psikosocial)
- Shërbimi i strehimit social

QËLLIMI 1. KRIJIMI I KUSHTEVE TË NEVOJSHME PËR NGRITJEN E SISTEMIT KOMUNITAR TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Objektivi 1. Strukturat përgjegjëse për shërbimin social në të dy nivelet e organizimit të Bashkisë do të kenë burimet njerëzore, infrastrukturën dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur cilësisht detyrimet ligjore

Aktiviteti 1.1 Rishikim i strukturës, roleve dhe funksioneve të Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social në Bashki

Sektori i ndihmës dhe shërbimit social do të përmbushë këto funksione: (i) Koordinimi dhe drejtimi i zbatimit të programeve të pagesave cash NE dhe PAK për të gjithë territorin e Bashkisë. (ii) Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivelin komunitar. (iii) Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët. (iv) Barazia gjinore dhe masa kundër dhunës në familje. (v) koordinimi i masave për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;

Sektori do të ketë përbërjen:

- Përgjegjës sektori (1)
- Specialist i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale (1 punonjës social)
- Njësia e Mbrojtjes së fëmijës (1 punonjës social)
- Koordinator i barazisë gjinore dhe masa kundër dhunës në familje (1 punonjës social ose psikolog)

Detyrat thelbësore në vijim do të bëhen pjesë e Rregullores së Bashkisë:

Përgjegjës sektori (1) - Koordinon, drejton të gjithë aktivitetin e sektorit në të gjithë komponentët në përputhje me funksionet e sektorit.

Specialist i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale (1) - Drejton punën për identifikimin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin në juridiksionin e bashkisë; Hartimi i projekt Planit Social vendor duke kostuar shërbimet e nevojshme të identifikuara, si dhe përgatitjen e Programit Buxhetor vjetor përkatës, për miratim në këshillin bashkiak; planifikimi i kalendarit të shpërndarjes vjetore dhe sigurimin e ofrimit të paketës bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror gjatë një viti; Krijimi i sistemit të mbikëqyrjes së shërbimeve në territorin e bashkisë; Propozimi i përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për miratim nga Këshilli Bashkiak; Punon për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve sociale (pa përfshirë rastet e fëmijëve dhe dhunës në familje) në territorin e Bashkisë; Përmbush detyra që lidhen me fuqizimin ekonomik të familjeve pa të ardhura sipas parashikimeve në Planin Social; Përmbush detyra që rrjedhin nga ligji për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Koordinatori për barazinë gjinore dhe masa kundër dhunës në familje (1)- Ka funksionin e menaxherit të rastit për rastet e dhunës në familje. Raporton në Komitetin Drejtues mbi situatën e dhunës në familje dhe masat për parandalim dhe adresimin e nevojave të viktimave. Koordinon Grupin Teknik Ndërsektorial dhe siguron burime ose i referon pranë shërbimeve. Siguron që të gjitha rastet e dhunës në familje të ndjekin të gjitha procedurat dhe siguron informacion gjithëpërfshirës dhe të përditësuar mbi situatën. Koordinon punën e të gjithë aktorëve dhe ofruesve të shërbimeve publike dhe jo publike për të garantuar nëpërmjet masave ligjore mbrojtje të anëtarëve të familjes që janë viktimat e dhunës në familje. Monitoron situatën e viktimave të dhunës përgjatë periudhës së urdhërit të mbrojtjes dhe informon strukturat e policisë. Përbush detyra të punonjësit për Çështjet e Barazisë Gjinore: harton politika, programe, dokumenta sipas këndvështrimit gjinor. Është përgjegjës për integrimin e çështjeve të barazisë gjinore në politika, programe e dokumenta që hartohen nga bashkia.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës (1) - Menaxhon rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje; Supervizon mirëqenien dhe përparimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në përputhje me Planin Individual të Mbrojtjes; I raporton në mënyrë periodike Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve (ASHMDF), me të dhëna statistikore të procesuara mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë; Identifikon të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jo publike për mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë, përfshi përfaqësuesit e shërbimeve të përkujdesit alternativ, shërbimeve shëndetësore, psikologjike, sociale, ligjore, punonjësit e specializuar të policisë, përfaqësuesit e prokurorisë dhe institucionet arsimore; Mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial dhe koordinon funksionimin e tij, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, referimin dhe ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve, lidhur me Masat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Mbrojtjes; Rrit ndërgjegjësimin e komunitetit mbi mbrojtjen e fëmijëve, organizon aktivitete informuese, edukuese dhe trajnuese mbi mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë; Shërben si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen mbi apo të referohen tek shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave të tyre; Harton dhe rishikon në mënyrë të përvitshme listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimat dhe dëshmitarë në proceset penale dhe ia dërgon strukturave vendore të policisë së shtetit, si dhe prokurorive dhe gjykatave përkatëse.

Aktiviteti 1.2. Ngritja dhe funksionimi i Njësisë të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësitë administrative

Ngritja e njësive ndjek përcaktimet në secilin prej ligjeve të specifikuara në analizën ligjore. Specifikisht: për çdo 6 mijë-10 mijë banorë pjesë e njësive duhet të jetë 1 punonjës social. Për çdo 3 mijë fëmijë pjesë e këtyre njësive është punonjësi i mbrojtjes së fëmijës. Në njësi përfshihet dhe administratori shoqëror që përmbush detyra që rrjedhin nga ligji për asistencën sociale. Në tabelën 2 jepen të dhënat referencë mbi bazën e të cilave është përcaktuar përbërja e 10 Njësive të Vlerësimit të Nevojave që duhet të ngrihen në nivelin e njësive administrative të Bashkisë Gramsh.

Tabela 2: Përbërja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

NJESIA ADMINISTRATIVE	TE DHENAT REFERENCE				NJESIA E VLERESIMIT TE NEVOJAVE DHE REFERIMIT		
	Nr. Banorë	Nr. Fëmijë	Nr.familje NE	Nr. Individ PAK	Punonjës Social	PMF	Administrator shoqëror
Gramsh	16,272	3,536	319	420	1	1	1
Skënderbegas			182	69	0	0	1
Kushovë			128	34	0	0	1
Kodovjat	4,162	1,091	315	128	0	0	1
Lenie			125	33	0	0	1
Kukur	2,905	802	329	99	0	0	1
Pishaj	9,730	2,531	430	202	1	0	1
Sult			110	47	0	0	1
Poroçan			204	85	0	0	1
Tunjë	2,080	518	206	84	0	0	1
TOTALI	35,149	8,478	2,358	1,201	2	1	10

Detyrat e stafit në vijim do të jenë pjesë e Rregullores së rishikuar të Bashkisë:

Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Gramsh

Punonjësi social kryen për territorin e njësisë administrative Gramsh: identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë; vlerësimin fillestar të nevojave dhe të nivelit të riskut

për individët në nevojë; informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla; hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjesisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm; përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfitur nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit; mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar; hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar. Ndërvepron me koordinatorin për masa kundër dhunës në familje për menaxhimin e rasteve të dhunës.

Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës për territorin e njësisë administrative Gramsh: Përgatit vlerësimin e rrezikut të fëmijëve në nevojë për mbrojtje; Përditëson bazën e të dhënave të mbrojtjes së fëmijëve me informacion mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje, Masat e Mbrojtjes dhe Planin Individual të Mbrojtjes; Mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial në nivelin e njësisë administrative dhe merr masa për zbatimin e vlerësimit të rastit të çdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe përgatitjen e një Plani Individual Mbrojtjeje, i cili përfshin propozimin për marrjen e Masave të Mbrojtjes; Informon NJMF dhe përgjegjës të strukturës përgjegjëse në bashki mbi Planin Individual të Mbrojtjes dhe propozimin për marrjen e Masave të Mbrojtjes dhe koordinon ndërhyrjet dhe veprimet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes; Monitoron zbatimin e Masës së mbrojtjes dhe përparimin e zhvillimit të fëmijës nën këtë masë mbrojtjeje; I kërkon anëtarëve të Grupit Teknik Ndërsektorial informacion mbi përparimin, sfidat dhe problemet e hasura gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes; Propozon ndryshimin apo heqjen e Masës së Mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo mbylljen e Planit Individual të Mbrojtjes, nëse kushtet për shkak të të cilave ishte marrë masa dhe ishte ndërtuar plani, nuk ekzistojnë më, apo kur një propozim i tillë i shërben fëmijës dhe është në interesin e tij/e saj më të mirë; Lehtëson dhe mbështet fëmijën dhe/ose familjen e tij/saj në kryerjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes; Merr pjesë në procese gjyqësore ku diskutohen Masat e Mbrojtjes të propozuara në Planin Individual të Mbrojtjes për rastet e fëmijëve që ai/ajo po menaxhon; I kërkon prokurorit heqjen e përgjegjesisë prindërore, duke e informuar atë mbi prindërit që shfaqin mungesë të fortë përkujdesi në ushtrimin e përgjegjesisë prindërore.

Administratori shoqëror: Administron, zbaton dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë; Identifikon dhe Referon individët dhe familjet në nevojë tek punonjësi social sipas nevojave; Propozon dhe

kontribuon në përmirësimin e politikave, programeve, dokumentave dhe kornizës ligjore në mbështetje të individëve në nevojë dhe në përputhje me prioritetet kombëtare dhe lokale; Koordinon punën dhe ofron mbështetjen e nevojshme për të parandaluar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet në nevojë duke iu referuar një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës; Përgatit, monitoron dhe bashkëpunon në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave kombëtare në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore duke respektuar formatin e miratuar nga Ministria e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale si autoriteti përgjegjës.

Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Pishaj

Punonjësi social kryen për territorin e njësisë administrative Pishaj: identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë (përfshirë rastet e dhunës dhe të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje); vlerësimin fillestar të nevojave dhe të nivelit të riskut për individët në nevojë; informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla; hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm; përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit; mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar; hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar. Ndërvepron me koordinatorin për masa kundër dhunës në familje për menaxhimin e rasteve të dhunës, si dhe me NJMF pranë strukturës përgjegjëse në Bashki për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Administratori shoqëror: Administron, zbaton dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë; Identifikon dhe Referon individët dhe familjet në nevojë tek punonjësi social sipas nevojave; Propozon dhe kontribuon në përmirësimin e politikave, programeve, dokumentave dhe kornizës ligjore në mbështetje të individëve në nevojë dhe në përputhje me prioritetet kombëtare dhe lokale; Koordinon punën dhe ofron mbështetjen e nevojshme për të parandaluar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet në nevojë duke iu referuar një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës; Përgatit, monitoron dhe bashkëpunon në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave

kombëtare në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore duke respektuar formatin e miratuar nga Ministria e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale si autoriteti përgjegjës.

8 Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit që kanë vetëm administratorin shoqëror

Administratori shoqëror: Administron, zbaton dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë; Identifikon dhe Referon individët dhe familjet në nevojë tek punonjësi social sipas nevojave; Propozon dhe kontribuon në përmirësimin e politikave, programeve, dokumentave dhe kornizës ligjore në mbështetje të individëve në nevojë dhe në përputhje me prioritetet kombëtare dhe lokale; Koordinon punën dhe ofron mbështetjen e nevojshme për të parandaluar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet në nevojë duke iu referuar një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës; Përgatit, monitoron dhe bashkëpunon në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave kombëtare në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore duke respektuar formatin e miratuar nga Ministria e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale si autoriteti përgjegjës. Kryen identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë; vlerësimin fillestar të nevojave dhe të nivelit të riskut për individët në nevojë; informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla; hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; Ndërvepron me koordinatorin për masa kundër dhunës në familje për menaxhimin e rasteve të dhunës, si dhe me NJMF pranë strukturës përgjegjëse në Bashki për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Aktiviteti 1. 3 Trainime të stafit të Sektorit të Ndihmës dhe Shërbimit Social në Bashki dhe Njësitë të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Trainimet do të ndërtohen në përputhje me nevojat e personelit të të dy niveleve të organizimit (Sektori dhe NJVNR), si dhe të funksioneve që duhet të përmbushin këto struktura.

Trainimet për personelin e Sektorit të Ndihmës dhe Shërbimit Social do të fokusohen të paktën në këto çështje:

- Planifikimi strategjik dhe buxhetimi i sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Mekanizmi i financimit të shërbimeve dhe teknika të hartimit të projekteve sociale.

- Standartet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, prokurimi dhe monitorimi i shërbimeve.

Trainimet për personelin e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit do të përfshijnë të paktën:

- Njohuri të thelluara mbi paketën legjislative të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël;
- Teknika të punës në ekip dhe menaxhimit të rasteve sociale.
- Trainime specifike për çështje të mbrojtjes së fëmijës, viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit, si dhe këshillimi për punësim.

Aktiviteti 1.4. Vizita studimore

Stafi i Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social do të zhvilloj vizita studimore në Bashkitë Elbasan dhe Tiranë për tu njohur praktikisht me funksionimin e atyre tipeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror që egzistojnë në këto Bashki dhe që do të ngrihen në Bashkinë Gramsh sipas parashikimeve të këtij Plani. Vizitat do të lehtësojnë të kuptuarin e procedurave për ngritjen e shërbimit, sikurse dhe funksionimin praktik të çdo shërbimi specifik.

Aktiviteti 1.5 Përmirësimi i infrastrukturës së punës së Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social, si dhe Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit

Puna me grupet vulnerabël, veçanërisht menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo e viktimave të dhunës në familje, kërkon mjedise pune të përshtatëshme. Njësia e Vlerësimit të Nevojave për njësinë administrative Gramsh, edhe pse mbetet pjesë e strukturës së Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social, do të ketë ambjente pune të veçanta nga pjesa tjetër e stafit të këtij sektori. Ambjentet do të jenë të përshtatëshme për të mundësuar konfidencialitetin gjatë intervistimit si të personave që përfitojnë nga programi i pagesave cash, ashtu edhe të çdo individit që ka të nevojshëm shërbime specifike kujdesi shoqëror. Ambjente që mundësojnë konfidencialitetin e intervistimit do të krijohen në çdo njësi administrative.

Stafi i Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social brenda gjashtëmujorit të parë të zbatimit të këtij plani do të përgatisë dhe do të udhëzojë stafet e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit mbi protokollet e punës për menaxhimin e rasteve. Në mënyrë të veçantë: aksesit dhe hedhja e të dhënave në Rregjistrin Elektronik të Shërbimeve Sociale, paketën me të gjithë formularët për identifikimin dhe raportimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime,

fëmijëve në nevojë për mbrojtje, viktimave të dhunës, si dhe çdo tip formulari të përcaktuar në legjislacion dhe akte nënligjore.

Aktiviteti 1.6 Mbledhja, analizimi dhe raportimi i situatës së grupeve vulnerabël në territorin e Bashkisë.

Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social brenda vitit të parë të zbatimit të Planit do të identifikojë treguesit social, periodicitetin e mbledhjes së tyre dhe institucionet brenda dhe jashtë Bashkisë nga do ti sigurojë këto të dhëna. Analiza periodike e ndërtuar mbi treguesit social, komunikimi me grupet në nevojë për shërbime dhe aktorët publikë e jopublikë që kanë role e përgjegjësi në adresimin e nevojave të këtyre grupeve do të jetë udhërrëfyese si në formulimin e politikave lokale specifike për grupet në nevojë, ashtu edhe rishikimin e përvitshëm të Planit Social të Bashkisë. Në kushtet që nuk mund të ketë politika sociale lokale pa mbajtur në konsideratë zërin e çdo grupi në nevojë për mbrojtje e përkujdesje, Sektori i ndihmës dhe shërbimit social do të zhvilloj çdo vit dëgjesa me secilin prej këtyre grupeve. Dëgjesa do të zhvillohen veçanërisht me: fëmijët, viktimat e dhunës në familje, përfaqësues të komunitetit rom/egjiptian, përfaqësues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit. Pas ngritjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror të parashikuar në këtë Plan, kjo strukturë si pjesë e procesit të monitorimit të cilësisë së shërbimeve do të zhvilloj intervista/fokus grupe me përfitues të drejtpërdrejtë të këtyre shërbimeve. Analiza e të gjitha të dhënave dhe konsultimeve të kryera do të mundësojë rishikimin e përvitshëm të Planit Social.

QËLLIMI 2. FUQIZIM EKONOMIK PËR FAMILJET PA TË ARDHURA OSE ME TË ARDHURA TË PAMJAFTUESHME

Objektivi 1. Fuqizim ekonomik dhe riintegrim i të paktën 20% të individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike apo në kërkim të një pune

Aktiviteti 1.1. Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit lokal për nxitjen e fuqizimit ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe grupeve në nevojë

Specialisti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale gjatë vitit të parë të zbatimit të Planit në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për taksat do të ndërtojë bazën e të dhënave të

bizneseve që kanë potenciale punësimi në të gjithë territorin e Bashkisë. Në përfundim të këtij procesi Bashkia do të thërras në një tryezë të gjithë drejtuesit e bizneseve, përfaqësues të Zyrës së Punës, Qendrës Rajonale të Formimit Profesional, Agjensisë së Zhvillimit të Bujqësisë dega Rajonale Elbasan, si dhe organizata joqeveritare të identifikuara që zhvillojnë projekte të fuqizimit ekonomik. Tryeza do të synojë të rrisë ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve që kanë kapacitete për punësim për nevojën e përfshirjes në tregun e punës së individëve në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Do të diskutohen gjithashtu forma të ndërveprimit mes Bashkisë-biznesit-Zyrës së Punës-AZHB- Formimit profesional me qëllim përmbushjen e objektivit të fuqizimit ekonomik të familjeve dhe zbutjes së varfërisë në këtë Bashki. Mbi bazën e konkluzioneve të tryezës Specialisti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale do të ndërtoj një Plan-Veprimi mes aktorësh me target punësimin e familjeve dhe individëve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Masat e këtij Plani do të përforcojnë masat e parashikuara në Planin Social në funksion të fuqizimit ekonomik. Në secilin nga dy vitet pasuese të këtij Plani kjo tryezë do të rimblidhet për të diskutuar mbi rezultatet, sfidat dhe përmirësimet e mundshme.

Aktiviteti 1.2 Këshillimi për punësim dhe ofertat e punës

Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit do të punojnë në partneritet me specialistët e Zyrës së Punës për të ndërgjegjësuar çdo individ në vështirësi ekonomike mbi domosdoshmërinë e pranimit të ofertës së punës dhe shmangien e punës në të zezë. Përfaqësuesi i Zyrës së Punës së bashku me administratorin shoqëror do të zhvillojnë në ambjentet e njësive administrative respektive takime informuese dhe këshilluese me individët madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Këshillimet do të zhvillohen dy herë në vit pranë çdo njësie administrative. Takimet këshilluese do të targetojnë gjithashtu personat me aftësi të kufizuara për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Për çdo vend pune të krijuar për të cilën informohet Zyra e Punës, informacioni do të përcillet në Sektorin e ndihmës dhe shërbimit social. Ky i fundit publikon njoftimin në ambjentet e Bashkisë të aksesueshme për publikun, si dhe ua përcjell Njësitë të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të çdo njësie administrative. Përveç publikimit në ambjentet e njësive administratorët shoqëror komunikojnë drejtpërdrejtë edhe me individët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

Aktiviteti 1.3 Program i Bashkisë për fuqizimin ekonomik

Masat e parashikuara në këtë aktivitet do të pasurohen me Planin e Veprimit që do të ndërtohet si pjesë e aktivitetit 1.1 të Qëllimit 2 të Planit Social. Në këto kushte programi do të përfshijë të paktën:

1. Në vijim të takimit të parë të mekanizmit lokal të ngritur, Bashkia dhe Zyra e Punës ngrënë një grup teknik të përbashkët për të kryer një vlerësim më të thelluar të karakteristikave të tregut të punës në Bashkinë Gramsh. Synimi do të jetë identifikimi i profileve të ndryshme të punës në mënyrë që edhe formimi profesional të jetë i orientuar drejt atyre kurseve që i përgatisin realisht për punë individët në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, sikurse masat për fuqizim ekonomik të jenë më mirë të orientuara sipas nevojave. Grupi teknik do të drejtohet nga sektori i ndihmës dhe shërbimit social dhe do të përbëhet të paktën nga: përfaqësues të Zyrës së Punës, formimit profesional, organizata joqeveritare të identifikuar që punojnë për fuqizimin ekonomik të familjeve më të varfëra. Produkt i punës së këtij grupi do të jetë listimi i profesioneve që mund të ushtrohen realisht në territorin e Bashkisë në përputhje me karakteristikat e tregut të punës. Në përputhje me këtë listë shërbimet e formimit profesional do të orientojnë kurset që i ofrojnë individëve në kërkim të një pune.

2. Punësim i të rinjve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Çdo vit 5 të rinj të sapodiplomuar, kryesisht të familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, do të punësohen për gjashtë muaj sipas profesionit që kanë në biznese lokale apo në Bashkinë Gramsh. Bashkia do të financojë për pagat e tyre në masën 26.000 lekë/muaj.

3. Sipërmarrjet sociale. Bashkia do të shfrytëzojë hapësirat që krijon ligji “Për ndërmarrjet sociale”, me qëllim ngritjen e bizneseve sociale. Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social do të punojë për të identifikuar organizata joqeveritare të cilat kanë kapacitetet për tu rregjistruar si biznese sociale dhe për të aplikuar për fonde për ngritjen e këtyre bizneseve. Plani Social dhe studimi mbi karakteristikat e tregut të Punës në këtë Bashki do të ndihmojë për të identifikuar tipe biznesesh që sigurojnë të ardhura për familjet, si dhe grupet që do të targetojnë këto biznese. Këto të fundit do të përzgjidhen mbi bazën e analizës së vulnerabilitetit që ka mundësuar ky Plan Social.

QËLLIMI 3. OFRIM I SHËRBIMEVE SIPAS NEVOJAVE PËRMES SISTEMIT KOMUNITAR TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Objektivi 1: Sistemi komunitar do të mundësojë mbrojtje e përkujdesje për çdo fëmijë në situatë të pafavorshme

Aktiviteti 1.1 Informim, këshillim dhe ndërgjegjësim komunitar

Mekanizmi lokal i ngritur do të ndërmarrë fushata informimi e ndërgjegjësimi në shkolla dhe në komunitet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, veçanërisht në zonat më të thella të Bashkisë. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në Bashki do të përgatisë çdo fillim viti, në konsultim me aktorët e përfshirë në grupet teknike ndërsektoriale, kalendarin e takimeve në shkolla dhe në komunitet me qëllim ndërgjegjësimin mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe informimin e tyre e të fëmijëve mbi ku dhe si të referojnë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Zbatimi do të përfshijë Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, kryetarët e fshatrave dhe përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave pjesë e mekanizmit lokal. Të paktën 12 takime komunitare do të zhvillohen në secilin prej tre viteve të zbatimit të Planit Social në zonat më problematike të Bashkisë në këndvështrimin e njohjes e respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Aktiviteti 1.2 Shërbimi i këshillimit me telefon për fëmijët

Përmes një marrëveshje bashkëpunimi Bashkia do të ndërtoj partneritetin me Linjën Kombëtare për Fëmijë “Alo 116 111” me qëllim që linja telefonike 24 orë në 7 ditë të javës të ofroj mbështetje, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo përkujdesje. Në takimet me komunitetin dhe fëmijët numri i Linjës do të publikohet vazhdimisht me qëllim krijimin e aksesit tek kjo formë shërbimi.

Aktiviteti 1.3 Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje dhe referimi tek shërbimet

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje kryhet në përputhje me parashikimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave 578 datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”²¹. Në njësinë administrative Gramsh për menaxhimin e rasteve Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës do të ndërveprojë me punonjësi social dhe administratorin shoqëror, si dhe me grupin teknik ndërsektorial. Në njësinë administrative Pishaj rastet do të menaxhohen nga punonjësi social i Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Në njësitë e tjera administrative PMF e sektorit të ndihmës dhe shërbimit social do të ndërveprojë me administratorin shoqëror të

²¹ <http://differentandequal.org/ep-content/uploads/2019/09/VKM-nr.-578-dt-3.10.2018.pdf>

njesisë administrative respektive. Në përputhje me Planin Individual të Mbrojtjes do të kryhet referimi tek shërbimet specifike si dhe monitorimi i situatës së fëmijës.

Aktiviteti 1.4 Qendër ditore dhe shërbim i emergjencës për rastet e fëmijëve të dhunuar, shfrytëzuar ose pa kujdes prindëror

Qendra do të ngrihet në territorin e njesisë administrative Gramsh dhe në të do të marrin shërbim të paktën 30 fëmijë çdo ditë. Qendra do të ngrihet në përputhje me standartin kombëtar²² dhe do të ofrojë mbështetje për arsimim, aktivitete sociale, ushqim etj. Do të priorizohen fëmijët e familjeve ekstremisht të varfëra, fëmijë të viktimave të dhunës në familje, të familjeve me nënkryefamiljare etj. Rastet e emergjencës do të referohen pranë qendrës nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, dhe në përputhje me nevojat e identifikuara shërbimi i emergjencës do të përfshijë pako ushqimore dhe higjienike.

Qendra do të ofrojë gjithashtu shërbim psikologjik e kurse prindërimi në mënyrë të veçantë për familjet biologjike, por edhe familjet e mundshme kujdestare. Një shërbim i tillë do të mundësojë jo vetëm adresimin e nevojave për këshillim psikologjik për fëmijë e familje, por do të hedhi bazat për ngritjen e shërbimit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, i cili do të zhvillohet më tej pas përfundimit të periudhës tre vjeçare të këtij Plani.

Aktiviteti 1.5 Qendra ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara

Qendra egzistuese do të vijoj aktivitetin e saj, duke plotësuar nevojat për personel, si dhe duke zgjeruar aktivitetin edhe me shërbimin në familje për fëmijët me aftësi të kufizuar. Shërbimi në shtëpi do të ngrihet në përputhje me standartin e shërbimit asistencë në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara²³. Shërbimet ofrohen nga profesionistë: logopedist, fizioterapist, okupacionist, përveç personelit mbështetës dhe synojnë të nxisin zhvillimin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara deri në moshën 21 vjeçare. Në mënyrë të veçantë do të synohet ndërhyrja e herëshme për fëmijët parashkollorë që janë në rrezik për të zhvilluar aftësi të kufizuar apo kanë lindur me aftësi të kufizuar fizike, mendore, shqisore etj. Fëmijës do ti ofrohet ndërhyrje terapeutike multidisiplinare sipas nevojave të veçanta që paraqet (terapist të foluri, fizik, okupacional, etj.) në mjedisin ku fëmija ushtron aktivitetin e përditshëm (në kopësht, shkollë apo qendrën ditore). Ndërveprimi me sistemin arsimor lokal

²² <http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2016/12/VENDIM.pdf>

²³ <http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2014/03/udhezim-597-dt.22.12.17.pdf>

do të jetë prioritet për të mundësuar këtë formë shërbimi. Qendra do të ketë një mjet transporti të përshtatur.

Objektivi 2: Rritje e denoncimit të dhunës në familje dhe adresim efektiv i nevojave për reabilitim dhe fuqizim të viktimave të saj

Aktiviteti 2.1 Parandalimi i dhunës në familje dhe denoncimi i rasteve

Mekanizmi lokal (i drejtuar nga Bashkia) do të ndërmarrë fushata informimi e ndërgjegjësimi në komunitet, veçanërisht në zonat më të thella të Bashkisë ku dhunë ka, por nuk raportohet. Koordinator i vendor për masa kundër dhunës në familje do të përgatisë çdo fillim viti, në konsultim me aktorët e përfshirë në grupet teknike multisektoriale, kalendarin e takimeve në komunitet me qëllim ndërgjegjësimin mbi dhunën në familje, efektet e saj dhe domosdoshmërinë e denoncimit të rasteve. Komunitetet do të informohen gjithashtu se si dhe ku të referojnë rastet. Takimet në komunitet do të organizohen nga koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje në bashkëpunim me Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, të mbështetur nga kryetarët e fshatrave, përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave pjesë e mekanizmit lokal. Të paktën 12 takime komunitare do të zhvillohen në secilin prej tre viteve të zbatimit të Planit Social në zonat më problematike të Bashkisë.

Aktiviteti 2.2 Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje dhe referimi tek shërbimet

Menaxhimi i rasteve të viktimave të dhunës në familje do të kryhet në përputhje me parashikimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”²⁴. Koordinator i vendor për masa kundër dhunës në familje do të drejtojë ekipin teknik ndërdisiplinor, i cili do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të përcaktuara nga Komiteti Drejtues në nivelin vendor. Për menaxhimin e rasteve do të ndërveprojë gjithashtu me punonjësin social (në rastin e njësive Gramsh dhe Pishaj) dhe administratorin shoqëror (në njësitë e tjera administrative) sipas vendbanimit të viktimës së dhunës në familje. Në përputhje me Planin Individual të Mbrojtjes do të kryhet referimi tek shërbimet specifike, si dhe monitorimi i situatës së viktimës së dhunës në familje.

Aktiviteti 2.3 Shërbimi i këshillimit me telefon për viktimat e dhunës në familje

²⁴ <http://www.ikub.al/LIGJE/1106160110/article-per-mekanizmin-e-bashkerendimit-te-punes-per-referimin-e-rasteve-te-dhunes-ne-marredheniet-familjare-dhe-menyren-e-procedimit-te-tij-.aspx?cookiesenabled=false>

Ky shërbim është kombëtar dhe Bashkia do të ndërtoj partneritetin me Linjën Kombëtare me qëllim që linja telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, të ofroj mbështetje, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Në takimet në komunitet, si dhe në ambjentet e Bashkisë e njëjësive administrative do të publikohet numri i Linjës me qëllim që çdo rast të mund të aksesojë këtë formë shërbimi. Çdo rast i këshilluar nga Linja do ti referohet prej saj koordinatorit vendor për masa kundër dhunës në familje me qëllim vijimin e menaxhimit të rastit dhe referimin tek shërbime të tjera të nevojshme.

Aktiviteti 2.4 Shërbimi i strehimit të mbrojtur/strehim social për viktimat e dhunës në familje

Rastet e emergjencës në periudhën tre vjeçare të zbatimit të këtij Plani do të vijnë të adresohen përmes shërbimit të ngritur në nivelin e qarkut nga Forumi i Pavarur i Gruas Elbasan. Për çdo viktimitë të dhunës në familje (apo dhe viktimat e mundshme trafikimi) përmes programit të strehimit social do të mundësohet shërbimi i strehimit të mbrojtur. Dy banesa sociale do të presin e akomodojnë viktimat e dhunës dhe fëmijët e tyre. Koordinator vendor për masa kundër dhunës në familje si pjesë e menaxhimit të rastit do të vijoj të koordinojë me shërbime të tjera (shërbimi psikologjik, ligjor, punësimi, formimi profesional) me qëllim fuqizimin dhe riintegrimin ekonomik e social të viktimës së dhunës. Programet për fuqizimin ekonomik, pjesë e Planit Social, do të targetojnë me prioritet viktimat e dhunës në familje.

Objektivi 3 Çdo individ në nevojë për shërbime rehabilituese, mbështetëse dhe riintegruese do ti përfitojë ato në përputhje me kriteret ligjore

Aktiviteti 3.1 Qendër ditore multifunkionale

Shërbimet e kësaj Qendre do të adresojnë nevojat e : (i) personave me aftësi të kufizuara të grupmohës mbi 21 vjeç; (ii) të moshuarve në situatë të vështirë ekonomike; (iii) çdo individ që ka të nevojshme shërbime psikosociale e veçanërisht individëve të familjeve që kanë përjetuar divorc, përdoruesve të drogës dhe alkoolit.

(i) *Për personat me aftësi të kufizuara* Qendra do të shërbej gjithashtu për informimin, orientimin dhe këshillimin, si dhe advokimin për të drejtat e tyre. Kjo formë shërbimi do të ofrohet nga vetë personat me aftësi të kufizuara të trainuar dhe të punësuar pranë saj. Qëllimi është që personat me aftësi të kufizuar të mbështeten dhe të arrijnë potencialin e tyre maksimal në gjirin e familjes dhe komunitetit. Qendra përmes informimit, orientimit,

ndërmjetësimi do të lehtësojë aksesin e personave me aftësi të kufizuara tek shërbime të tjera të nevojshme si: strehimi, punesimi, transporti, aktivitete shlodhese, akses në shërbimet sociale e shëndetësore.

(ii) Qendra do të ofroj *shërbime në shtëpi për të moshuarit* që jetojnë vetëm. Kjo formë shërbimi do të ngrihet në përputhje me standartin e shërbimit asistencë shtëpiake për të moshuarit²⁵.

(iii) Qendra do të ofroj shërbim psikosocial për çdo individ që e ka të nevojshëm këtë formë shërbimi dhe në mënyrë të veçantë do të ofrojë terapi individuale dhe në grup më përdorues të drogës, alkoolit apo të divorcuar.

Aktiviteti 3.2 Shërbimi i strehimit social

Bashkia do të vijoj të mbështesë grupet në nevojë të identifikuar në këtë plan Social përmes aplikimit të tre programeve, sipas nevojave të vlerësuara nga Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për çdo aplikant:

1. Bonus i qerasë për familje me të ardhura të pamjaftueshme çdo vit.
2. Banesa sociale.
3. Rikonstrukcion banese për familjet rome/egjiptiane

Përmes këtyre programeve Bashkia do të trajtojë çdo vit me prioritet familje që kanë pamundësi për të përballuar koston e strehimit dhe në mënyrë të veçantë: Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë grua kryefamiljare; Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë më shumë se 2 fëmijë të mitur; Familje rome/egjiptiane; Familje përfituese të ndihmës ekonomike që kanë të paktën një pjestar me aftësi të kufizuara; Viktima të dhunës në familje; persona me aftësi të kufizuara.

²⁵ Udhëzim 581 datë 18.12.2017 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, asistencës shtëpiake për të moshuarit. Aksesuar në: http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2014/03/Udh%C3%ABzim_581_18.12.2017.pdf

4. PLANI I VEPRIMIT

QËLLIMI 1. KRIJIMI I KUSHTEVE TË NEVOJSHME PËR NGRITJEN E SISTEMIT KOMUNITAR TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	REFERENCA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
<p><i>Objektivi 1. Strukturat përgjegjëse për shërbimin social në të dy nivelet e organizimit të Bashkisë do të kenë burimet njerëzore, infrastrukturën dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur cilësisht detyrimet ligjore</i></p>							
<p>Aktiviteti 1. 1.</p> <p>Rishikim i strukturës, roleve dhe funksioneve të Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social në Bashki</p>	<p>Sektori i ndihmës dhe shërbimit social</p> <p>Sektori i administrimit të burimeve njerëzore</p>	2021	<p>Struktura përgjegjëse e organizuar në numër personeli dhe funksione sipas parashikimeve ligjore;</p> <p>Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për strukturën përgjegjëse dhe çdo specialisti sipas</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Ligji “Për vetëqeverisjen vendore</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e</p>	Bashkia		Zv. Kryetari

			parashikimeve ligjore;	fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "për asistencën sociale"		
Aktiviteti 1.2. Ngritja dhe funksionimi i Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësitë administrative	Sektori i ndihmës dhe shërbimit social Sektori i administrimit të burimeve njerëzore	2021	Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të organizuara në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore; Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për strukturën e Nj.V.N.R në njësinë administrative dhe çdo specialisti sipas parashikimeve ligjore;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "për asistencën sociale"	Bashkia	Zv. Kryetari

<p>Aktiviteti 1.3</p> <p>Trainime të stafit të Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social në Bashki dhe Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit</p>	<p>Sektori i ndihmës dhe shërbimit social</p>	<p>2021</p> <p>2022</p> <p>2023</p>	<p>Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushatat e identifikuara për ngritje kapacitësh;</p> <p>Numri i pjesëmarrësve në training në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë;</p> <p>Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet;</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Ligji “Për vetqeverisjen vendore”</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p> <p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”</p> <p>Ligji "për asistencën sociale"</p> <p>Ligji "Për të drejtën e informimit publik"</p> <p>Ligji "Për prokurimin Publik"</p>	<p>Bashkia, SHSSH dhe organizata partnere</p>		<p>Zv. Kryetari</p>
<p>Aktiviteti 1.4</p>	<p>Sektori i ndihmës dhe shërbimit social</p>	<p>2021</p>	<p>Numri i vizitave studimore të zhvilluara;</p>	<p>Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e</p>	<p>Bashkia në partneritet me Shërbimin</p>		<p>Zv. Kryetari</p>

Vizita studimore		2022	Praktika pune të ngritura për shkak të eksperiencës së fituar;	Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore”	Social Shtetëror		
Aktiviteti 1.5 Përmirësimi i infrastrukturës së punës së Sektorit të Ndhmës dhe Shërbimit Social, si dhe Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	Sektori i ndihmës dhe shërbimit social Sektori i Financës Njësia e investimeve në Bashki	2021 2022	Ambjentet e punës janë të përshtatura për punën me fëmijët, viktimat e dhunës dhe çdo individ në nevojë për të cilët duhen respektuar parimet e konfidencialitetit; Protokollet e unifikuar të punës, bashkë me paketën e formularëve për menaxhimin e rasteve sociale të përgatitura dhe të dërguara pranë NjVNR;	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore” Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji "për asistencen sociale";	Bashkia		Zv. Kryetari
Aktiviteti 1.6 Mbledhja, analizimi dhe raportimi i situatës së	Sektori i ndihmës dhe shërbimit social	2021 2022	Treguesit social të përcaktuar dhe mblidhen sistematikisht sipas	Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e	Bashkia		Zv. Kryetari

<p>grupeve vulnerabël në territorin e Bashkisë</p>		<p>2023</p> <p>periodicitetit të përcaktuar;</p> <p>Të paktën një konsultim i zhvilluar çdo vit individualisht me fëmijët, viktimat e dhunës në familje, përfaqësues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit;</p> <p>Numri i intervistave/fokus grupeve të zhvilluara me përfitues të shërbimeve të ngritura si pjesë e sistemit komunitar;</p> <p>Numri i pjesëmarrësve dhe çështjet e konsultuara në Konsultime me institucionale lokale dhe partnere me qëllim rishikimin e Planit Social;</p> <p>Plani Social i rishikuar çdo vit ka adresuar prioritetet e grupeve vulnerabël, si dhe të aktorëve të konsultuar;</p>	<p>Shqipërisë”</p> <p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p> <p>Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare”</p>			
---	--	---	---	--	--	--

QËLLIMI 2. FUQIZIM EKONOMIK PËR FAMILJET PA TË ARDHURA OSE ME TË ARDHURA TË PAMJAFTUESHME

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	REFERENCA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 1. Fuqizim ekonomik dhe riintegrim i të paktën 20% të individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike apo në kërkim të një pune							
Aktiviteti 1.1. Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit lokal për nxitjen e fuqizimit ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe grupeve në nevojë	Specialisti i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale/Sektori i ndihmës dhe shërbimit social Sektori i Tatim Taksave	2021 2022 2023	Baza e të dhënave të bizneseve dhe institucioneve e organizatave partnere e ngritur; Programi dhe Tryeza e zhvilluar janë në përputhje me objektivin e këtij aktiviteti; Janë identifikuar forma të ndërveprimit mes	Ligji “Për asistencën sociale” Ligji “Për nxitjen e Punësimit” Ligji “Për ndërmarrjet sociale”	Bashkia Partneritet me Zyrën e Punës, Qendrën Rajonale të Formimit Profesional, Agjensinë e Zhvillimit të Bujqësisë dega Rajonale, si dhe organizatave		Kabineti i Kryetarit të Bashkisë

			<p>Bashkisë-biznesit-Zyrës së Punës-AZHBR-Formimit profesional - organizatave me qëllim përmbushjen e objektivit të fuqizimit ekonomik të familjeve dhe zbutjes së varfërisë në këtë Bashki;</p> <p>Plani i Veprimit për fuqizimin ekonomik i hartuar brenda vitit të parë dhe monitorohet e rishikohet çd vit;</p> <p>Numri i individëve nga grupet në nevojë të punësuar përmes masave të zbatuara të këtij Plani;</p>		joqeveritare; territorin e Bashkisë		
Aktiviteti 1.2 Këshillimi për punësim	Administratorët shoqëror Specialisti i mbrojtjes dhe	2021 2022	Numri i individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, apo individëve në situatë të	Ligji “Për asistencën sociale” Ligji “Për nxitjen e	Bashkia Zyra e Punës		Zv. Kryetari Sektori i ndihmës dhe

	përfshirjes sociale Në partneritet me Zyrën e Punës	2023	pafavorshme të takuar e këshilluar për punësim; Numri i individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, apo individëve në situatë të pafavorshme të punësuar;	Punësimit” Urdhëri i Përbashkët i Ministres së Financës dhe Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi Protokollin e Bashkëpunimit mes SHSSH dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (gusht 2019)			shërbimit social
Aktiviteti 1.3 Program i Bashkisë për fuqizimin ekonomik: <i>1. Karakteristikat e tregut të punës (viti i parë)</i>	Spektori i ndihmës dhe shërbimit social	2021 2022 2023	Grupi teknik ka në përbërje përfaqësues të institucioneve që kanë role e përgjegjësi në drejtim të formimit profesional; Lista e profesioneve e	Ligji “Për ndërmarrjet sociale”	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Donatorë		Zv. Kryetari

<p>2. <i>Punësim i të rinjve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike (çdo vit)</i></p> <p>3. <i>Sipërmarrjet sociale (viti i parë identifikimi i partnerëve dhe vijon ço vit)</i></p>			<p>hartuar;</p> <p>Numri i kurseve të formimit profesional të ofruara në nevojë në përputhje me listën e profesioneve;</p> <p>Numri i të rinjve pjesëtarë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike të punësuar;</p> <p>Numri i bizneseve sociale të ngritura;</p> <p>Numri i individëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, vikitmave të dhunës në familje, personave me aftësi të kufizuara të punësuar në bizneset sociale të ngritura;</p>				
--	--	--	---	--	--	--	--

QËLLIMI 3. OFRIM I SHËRBIMEVE SIPAS NEVOJAVE PËRMES SISTEMIT KOMUNITAR TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	REFERENCA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
<p><i>Objektivi 1: Sistemi komunitar do të mundësojë mbrojtje e përkujdesje për çdo fëmijë në situatë të pafavorshme</i></p>							
<p>Aktiviteti 1.1</p> <p>Informim, këshillim dhe ndërgjegjësim komunitar</p> <p><i>Të paktën 12 takime komunitare në tre vjet</i></p>	<p>Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës</p> <p>Njësitë e Vlerësimit të nevojave dhe Referimit</p> <p>Kryetarët e fshatrave</p>	<p>2021</p> <p>2022</p> <p>2023</p>	<p>Numri i takimeve komunitare të zhvilluara;</p> <p>Çështjet e prezantuara dhe të diskutuara në përputhje me prioritetet e përcaktuara për informim e ndërgjegjësim për të drejtat e fëmijëve;</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"</p> <p>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"</p>	<p>Bashkia</p> <p>dhe çdo institucion i parashikuar në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës</p>		<p>Sektori i mbrojtjes dhe shërbimit social</p>

			<p>Numri i personave të përfshirë drejtpërdrejtë na takimet informuese e ndërgjegjësuese:</p> <p>Numri I rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje e përkuqdesje të identifikuar e mbështetur me shërbime;</p>				
<p>Aktiviteti 1.2</p> <p>Shërbimi i këshillimit me telefon për fëmijët</p>	<p>Spektori i mbrojtjes dhe shërbimit social</p>	<p>2021</p> <p>2022</p> <p>2023</p>	<p>Marrëveshje me linjën e Këshillimit për Fëmijë ALO 116111;</p> <p>Numri i rasteve të fëmijëve që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim;</p> <p>Numri i rasteve të</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"</p> <p>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"</p>	<p>Bashkia në partneritet me Linjën e Këshillimit për Fëmijë Alo 116111</p>		<p>Kabineti i Kryetarit</p>

			fëmijëve të referuar tek NJMF përmes linjës së këshillimit;				
Aktiviteti 1.3 Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje dhe referimi tek shërbimet	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës Njësitë e Vlerësimit të nevojave dhe Referimit	2021 2022 2023	Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale; Numri i rasteve të fëmijëve për të cilët janë marrë masa mbrojtëse; Numri i rasteve të fëmijëve të mbështetur me shërbime; Numri i takimeve ndërsektoriale të zhvilluara; Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" VKM nr. 578, datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes" VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit	Bashkia dhe çdo institucion i parashikuar në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës		Sektori i mbrojtjes dhe shërbimit social

			takime;	shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”			
Aktiviteti 1.4 Qendër ditore dhe shërbim i emergjencës për rastet e fëmijëve të dhunuar, shfrytëzuar ose pa kujdes prindëror	Sektori i mbrojtjes dhe shërbimit social	2022 2023	Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimit; Shërbimi i ngritur dhe funksional në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimit;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” Vendim nr. 231, datë 20.3.2013 “Për standartet e	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia		Zv.Kryetari

			<p>Numri i përfituesve të shërbimit që ofron qendra;</p> <p>Intervistat dhe fokus grupet e realizuara me përfitues të shërbimeve identifikojnë cilësinë e shërbimit nga këndvështrimi i përfituesve</p> <p>Raportet e monitorimit vlerësojnë qartësisht cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimit dhe rekomandojnë përmirësimet e nevojshme.</p>	shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë, në qendrat ditore publike dhe jopublike”			
Aktiviteti 1.5	Sektori i mbrojtjes dhe	2021	Shërbimi funksional në përputhje me	Ligji "Për shërbimet e	Fondi Social		Zv.Kryetari

<p>Qendër ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara</p>	<p>shërbimit social</p>	<p>2022 2023</p>	<p>standartet kombëtare për shërbimin specifik;</p> <p>Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimit;</p> <p>Numri i përfituesve të shërbimit që ofron qendra;</p> <p>Intervistat dhe fokus grupet e realizuara me përfitues të shërbimeve identifikojnë cilësinë e shërbimit nga këndvështrimi i përfituesve</p> <p>Raportet e monitorimit vlerësojnë qartësisht cilësinë dhe</p>	<p>kujdesit shoqëror"</p> <p>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"</p> <p>udhezim-597-dt.22.12.17 "Standarti i shërbimit asistencë në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara"</p>	<p>Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia</p>		
---	-------------------------	---------------------------	---	---	--	--	--

			përshtatshmërinë e shërbimit dhe rekomandojnë përmirësimet e nevojshme.				
Objektivi 2: Rritje e denoncimit të dhunës në familje dhe adresim efektiv i nevojave për rehabilitim dhe fuqizim të viktimave të saj							
Aktiviteti 2.1 Parandalimi i dhunës në familje dhe denoncimi i rasteve <i>(të paktën 12 takime në zonat më problematike)</i>	Koordinator vendor për masat kundër dhunës në familje Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Kryetarët e fshatrave	2021 2022 2023	Numri i takimeve komunitare të zhvilluara; Çështjet e prezantuara dhe të diskutuara në përputhje me prioritetet e përcaktuara për informim e ndërgjegjësim mbi dhunën në familje;	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" Ligji "Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" Vendimin e Këshillit të Ministrave 334, datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në	Bashkia në partneritet me pjestarët e mekanizmit lokal		Zv. Kryetari

			<p>Numri i personave të përfshirë drejtpërdrejtë na takimet informuese e ndërgjegjësuere:</p> <p>Numri i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje e përkujdesje të identifikuar e mbështetur me shërbime;</p>	<p>marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”</p>			
<p>Aktiviteti 2.2</p> <p>Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje dhe referimi tek shërbimet</p>	<p>Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje</p> <p>Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit</p>	<p>2021</p> <p>2022</p> <p>2023</p>	<p>Numri i rasteve të dhunës të referuara;</p> <p>Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes multisektoriale;</p> <p>Numri i viktimave të dhunës të pajisura me Urdhër mbrojtje/</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"</p> <p>VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për</p>	<p>Bashkia në partneritet me pjesëtarët e mekanizmit lokal</p>		<p>Sektori i ndihmës dhe shërbimit social</p>

			Urdhër të menjëhershëm mbrojtje; Numri i viktimave të dhunës që kanë marrë shërbime reabilituese/fuqizues e	shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” Ligji “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” Vendimin e Këshillit të Ministrave 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”			
Aktiviteti 2.3 Shërbimi i këshillimit me telefon për viktimat e dhunës në familje	Sektori i ndihmës dhe shërbimit social Koordinator vendor për	2021 2022 2023	Marrëveshje me linjën e Këshillimit për viktimat e dhunës në familje; Numri i rasteve të	Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" Ligji “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”	Bashkia		Kabineti i Kryetarit

	masat kundër dhunës në familje		<p>viktimave të dhunës që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim;</p> <p>Numri i rasteve të viktimave të dhunës të referuara nga Linja tek koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje;</p>	Vendimin e Këshillit të Ministrave 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”			
<p>Aktiviteti 2.4</p> <p>Shërbimi i strehimit të mbrojtur/strehim social per viktimat e dhunës në familje</p>	<p>Sektori i ndihmës dhe shërbimit social</p> <p>Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje</p>	<p>2021</p> <p>2022</p> <p>2023</p>	<p>Apartamentet funksionale për çdo rast;</p> <p>Staf i dedikuar dhe i trainuar për shërbim;</p> <p>Numri i rasteve të akomoduar në kushtet e emergjencës;</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"</p> <p>Ligji "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"</p> <p>VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar</p>	<p>Fondi Social</p> <p>Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia</p>		Zv.Kryetari

			Numri i rasteve që kanë përfituar shërbime rehabilituese dhe riintegruese;	dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” Vendim nr.505, datë 13.7.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”			
<p><i>Objektivi 3 Çdo individ në nevojë për shërbime rehabilituese, mbështetëse dhe riintegruese do të përfitojë ato në përputhje me</i></p>							

kriteret ligjore

<p>Aktiviteti 3.1</p> <p>Qendër ditore multifunkionale</p> <p>(i) <i>Për personat me aftësi të kufizuara mbi 21 vjeç</i></p> <p>(ii) <i>shërbime në shtëpi për të moshuarit</i></p> <p>(iii) <i>shërbim psikosocial për çdo individ që e ka të nevojshëm këtë formë shërbimi</i></p>	<p>Sektori i ndihmës dhe shërbimit social</p> <p>Ekipi i Qendrës Multi-funkionale</p>	<p>2021</p> <p>2022</p> <p>2023</p>	<p>Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve komunitare;</p> <p>Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik;</p> <p>Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;</p> <p>Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra;</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"</p> <p>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"</p> <p>Standarti Kombëtar i miratuar me Udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 911, datë 27.12.2018 "Për miratimin e</p>	<p>Fondi Social</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia</p>	<p>Sekretari i Përgjithshëm</p>
--	---	-------------------------------------	---	--	--	--

			Numri i përfituesve të shërbimeve të emergjencës pranë familjeve në territorin e Bashkisë;	standartit të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”			
Aktiviteti 3.2 Shërbimi i strehimit social	Spektori i ndihmës dhe shërbimit social	2021 2022 2023	Numri i familjeve që kanë përfituar bonus qeraje/strehim social në raport me numrin e familjeve që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, gra kryefamiljare, viktime të dhunës në familje, apo individë në nevojë të identifikuar në Planin Social.	Ligj "Për strehimin social" Ligj "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".	Bashkia me mbështetjen e Ministrisë së Financave		Zv.Kryetari

5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Siç shihet në Planin e Veprimit (seksioni 4) për çdo aktivitet të parashikuar është përcaktuar koha e zbatimit, e vlerësuar në përputhje me dy faktorë: (i) Prioriteti i ndërhyrjes, në përputhje me vlerësimin e kryer të nevojave, si dhe (ii) kapaciteti i Bashkisë në këndvështrimin e burimeve njerëzore dhe financiare. Në mënyrë të veçantë ngritja e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që kërkon si përgatitje të stafit social të Bashkisë ashtu edhe burime të duhura financiare, është parashikuar të ndodhë gradualisht në harkun kohor tre vjeçar të zbatimit të Planit. Në vitin e parë janë parashikuar të ngrihen shërbimet më të domosdoshme dhe gradualisht deri në vitin e tretë të arrihet ngritja e shportës minimale të shërbimeve.

Në plan është përcaktuar për çdo aktivitet njësi/stafi zbatues i aktivitetit specifik. Edhe pse zbatimi i planit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, në të është specifikuar, atje ku është e nevojshme, partneriteti me institucione të tilla si Shërbimi Social Shtetëror dhe Shërbimi i Punësimit, që kanë përgjegjësi ligjore në zbatimin e aktiviteteve specifike. Megjithatë sidomos në aktivitetet e fuqizimit ekonomik është thelbësore që Bashkia të zgjerojë partneritetin me organizata/ofrues të tjerë, gjë që do të mbetet detyrë e vazhdueshme e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki.

Plani do të jetë objekt rishikimi çdo vit veçanërisht në funksion të atyre aktiviteteve për të cilat duhet të mbahen në konsideratë zhvillimet afatshkurtra lokale dhe nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Procedurat e rishikimit janë përfshirë gjithashtu në aktivitetet e këtij Plani (shih aktiviteti 1.6, Qëllimi 1 i Planit).

Për efekt të monitorimit dhe vlerësimit për çdo aktivitet të Planit është parashikuar njësi/të përgjegjëse për monitorimin e çdo aktivitetit, ndërkohë që për çdo aktivitet është përcaktuar lista e treguesve që lehtësojnë procesin e monitorimit dhe vlerësimit sasior dhe cilësor të çdo aktiviteti. Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit do të jetë verifikimi se sa efektiv ka qenë zbatimi i aktiviteteve, a janë përmbushur në mënyrë të sukseshme qëllimet dhe objektivat e planit dhe mbi të gjitha çfarë ndikimi ka pasur zbatimi tek individët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Për të kryer monitorimin do të mblidhen të dhëna dhe informacion i nevojshëm për matjen e treguesve të përcaktuar. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara janë zbatuar në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Planit të Veprimit (në sasinë dhe cilësinë e parashikuar), sikurse të dhënat e mbledhura do të japin pamje të qartë mbi arritjet dhe problematikat që kanë dalë gjatë zbatimit të Planit. Intervista dhe fokus grupe me përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë parashikuar gjithashtu

me qëllim vlerësimin gjithëpërfshirës të funksionimit të sistemit që synon të ngrihet përmes zbatimit të këtij plani (shih aktiviteti 1.6 qëllimi 1 i Planit).

Bazuar në detyrimet ligjore, shumë prej aktiviteteve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontrolleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë.

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuar do të jenë bazë e Raportit njëvjeçar. Raporti do të shërbejë gjithashtu edhe për të rishikuar ato elementë të Planit trevjeçar që marrin një fokus të ri për shkak të arritjeve dhe problematikave të identifikuara në periudhën një vjeçare. Gjatë periudhës së zbatimit do të kryhen tre vlerësime, të cilat do të influencojnë drejtpërdrejt ne riorganizimin dhe riformulimin e objektivave specifike dhe aktiviteteve për vitet pasuese: (i) 2 vlerësime dhe Raporte vjetore (fund i vitit 2021, fund i vitit 2022). Këto raporte do shërbejnë edhe për të rishikuar Planin e Veprimit për vitin pasardhës; (ii) Vlerësimi dhe Raporti përfundimtar (fund i vitit 2023). Ky raport do të shërbejë edhe për të përgatitur Planin pasardhës afatmesëm të Bashkisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



United Nations
ALBANIA



6. PËRMBLEDHJE E BUXHETIT

REFERENCAT

MPV. (2015). Ligji për qeverisjen vendore. Aksesuar nga

http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/userfiles/LIGJI_139_2015_PER_VETEQEVERISJEN_VENDORE1.pdf

Ligj nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësve social në Republikën e Shqipërisë. Aksesuar nga,

http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/ndihma%20dhe%20perkujdesja%20shoqerore/Ligj_163_04122014_perditesuar.pdf

Ligj nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Aksesuar nga

http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/ndihma%20dhe%20perkujdesja%20shoqerore/Ligj_121_24112016.pdf

VKM nr. 518, date 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”. [Aksesuar nga](#)

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20132/VKM%20nr.%20518,%20date%204.9.2018.pdf>

VKM nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare” Aksesuar nga

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2037/VKM%20nr.%20149,%20date%2013.3.2018.pdf>

VKM nr.136, datë 7.3.2018 “Për funksionimin dhe administrimin e Rregjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”. Aksesuar nga

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2034/VKM%20nr.%20136,%20date%207.3.2018.pdf>

Ligji nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit. Aksesuar nga

<http://www.ikub.al/LIGJE/610310002/Article-Per-statusin-e-jetimit-.aspx>

VKM nr.233, datë 10.04.1998 “Për zbatimin e ligjit për statusin e jetimit”. Aksesuar nga

<http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2014/10/VKM-NR.233-Dt.10.04.1998-Jetimit.pdf>

VKM nr. 499, datë 29.08.2018 “Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”. Aksesuar nga

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20127/VKM%20nr.%20499,%20date%2029.8.2018.pdf>

Ligj nr.22/2018 “Për strehimin social”. Aksesuar nga <http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/ligj-nr.-22-dt.-3.5.2018-Per-strehimin-social.pdf>

Ligj nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Aksesuar nga https://www.uart.edu.al/media/150329-Ligji_10221_2010_per_mbrojtjen nga%20 diskriminimi.pdf

Ligj nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Aksesuar nga http://www.idp.al/ep-content/uploads/2016/11/Ligji_9887_date_10_-03_2008_i_ndryshuar-2.pdf

MMSR. (2017). Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Aksesuar nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2017/06/Agjenda-kombetare-per-te-drejtat-e-femijeve.pdf>

MMSR. (2017). Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Aksesuar nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2017/07/LIGJI-NR-18-2017-%E2%80%99CP%C3%8BR-T%C3%8B-DREJTAT-DHE-MBROJTJEN-E-F%C3%8BBIJ%C3%8BS%E2%80%9D.pdf>

KM. (2018). VKM Nr. 578, datë 3.10.2018 ‘Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes’. Aksesuar nga <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20144/VKM%20nr.%20578,%20date%203.10.2018.pdf>

KM. (2018). VKM Nr. 54, datë 31.1.2018 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës’. Aksesuar nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-54-date-31.1.2018.pdf>

KM. (2018). VKM Nr. 353, datë 12.6.2018 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative’ Aksesuar nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-353-date-12.6.2018.pdf>

KM. (2018). VKM Nr. 148, datë 13.3 2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës”. Aksesuar nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-148-date-13.3.2018.pdf>

KM. (2018). VKM Nr. 91, dt 14.02.2018c “ Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”. Aksesuar nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2018/08/VKM-Nr-91-dt-14.02.2018.pdf>

Ligji Nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar’. Aksesuar nga

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20115/LIGJ%20nr.%2047-2018,%20date%2023.7.2018.pdf>

KM. (2011). VKM Nr. 334, datë 17.2.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Aksesuar nga <https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/94182/110439/F-428843712/ALB-94182.pdf>

KM. (2011). Ligji për inspektimin. Aksesuar nga http://inspektoriatipunes.gov.al/ep-content/uploads/2014/02/Ligj_10433_16.06.2011.pdf

MMSR. (2015). Standardet për shërbimet në Qendrën Kombëtare Tranzit të Emergjencës. Aksesuar nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2015/07/Vendim-Nr.-573-datë-24.6.2015-Për-miratimin-e-Standardeve-të-Shërbimeve-të-Njërive-të-Mbrojtjes-së-Fëmijëve.pdf>

MMSR. (2015). Standardet e shërbimeve të njërive të mbrojtjes së fëmijës. Aksesuar nga <http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2015/07/Vendim-Nr.-573-datë-24.6.2015-Për-miratimin-e-Standardeve-të-Shërbimeve-të-Njërive-të-Mbrojtjes-së-Fëmijëve.pdf>

MMSR. (2013). Standardet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në nevojë në qendrat ditore. Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/54-2013.pdf

MMSR. (2011). Standardet e shërbimeve të kujdesit social për viktimat e dhunës në familje në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike. Aksesuar nga http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2016/12/Vendim-i-KM_505_13.07.2011-dhuna-rez.pdf

MMSR. (2010). Standardet e shërbimeve të kujdesit alternativ për fëmijët në nevojë. Aksesuar nga <http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2016/12/VENDIM-Nr.752-dat%C3%AB-8.9.2010-Per-standartet-e-kujdestarise.pdf>

MMSR. (2007). Standardet e shërbimeve shoqërore për personat e trafikuar ose personat në rrezik për trafikim, në qendrat rezidenciale. Aksesuar nga http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2016/12/Vendim-i-KM_195_11.04.2007-trafikimi-rez.pdf

MMSR. (2006). Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar në institucionet rezidenciale dhe ditore. Aksesuar nga http://inspektoriatipunes.gov.al/ep-content/uploads/2014/02/Vendim-i-KM_822_06.12.20061.pdf

MMSR. (2005). Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Aksesuar nga http://inspektoriatipunes.gov.al/ep-content/uploads/2014/02/Vendim-i-KM_658_17.10.2005.pdf

SHTOJCA 1: PROFILI DHE KARAKTERISTIKAT E KATEGORIVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

1. Individë në familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme

Tabela 1. Të dhëna të krahasuara për familjet aplikuese dhe përfituese të NE 2018, 2020

NJESIA ADMINISTRATIVE	DHJETOR 2018				PRILL 2020			
	FAMILJE APLIKUESE	FAMILJE PERFITUES E			FAMILJE APLIKUESE	FAMILJE PERFITUESE		
		RURAL	URBAN	% PRANIMIT		RURAL	URBAN	% PRANIMIT
Gramsh	317	-	301	94.9%	329	-	319	96.9%
Skenderbegas	234	221	-	94.4%	182	182	-	100%
Kushove	131	130	-	99.2%	128	128	-	100%
Pishaj	450	432	-	96%	448	430	-	95.9%
Sult	85	85	-	100%	110	110	-	100%
Tunje	199	196	-	98.4%	209	206	-	98.5%
Lenie	137	133	-	97%	125	125	-	100%
Kukur	373	364	-	97.5%	340	339	-	99%
Poroçan	215	215	-	100%	205	204	-	99.5%
Kodovjat	319	308	-	96.5%	319	315	-	98.7%
TOTALI	2460	2084	301	97%	2395	2039	319	99%

GRAFIK 1: FAMILJE NE SKEMEN E N.E SIPAS NJESIVE ADMINISTRATIVE





Tabela 2: Karakteristikat e familjeve përfituese të NE²⁶

BASHKIA	TOTAL Familje përfituese të NE	KARAKTERISTIKAT					
		Kryefamiljare grua	Deri në 2 fëmijë të mitur	Mbi 2 fëmijë të mitur	Rome/ egjiptiane	Me të paktën 1 anëtar PAK	Të paktën 1 pjestar në moshë pensionari
Gramsh	319					80	
Kushove	128	15	51	8	0	21	6
Pishaj	430	45			5	82	8
Kodovjat	315	23	102	18	-	65	17
Sult	110	4	28	29	0	17	11
Tunje	206					11	24
Skenderbegas	182	18	112	20	4	40	17
Porocan	204					51	
Kukur	339	20				61	20
Lenie	125					6	
TOTALI	2358	125	293	75	9	434	103

²⁶ Burimi: Rregjistri elektronik i ndihmës ekonomike, prill 2020


GRAFIK 2: NIVELI ARSIMOR I PUNEKERKUESVE



2. Personat me Aftësi të Kufizuara

Tabela 3: Personat me aftësi të kufizuara sipas diagnozës dhe njësisive administrative

Grafik 3: Niveli arsimor për të dy gjinitë



EMERTIMI	GJITHSEJ		TE VERBER		PARA-TETRA PLEGJIK		PAK FIZIK MENDOR	
	Gjithsej	Me kujdestar	Gjithsej	Me kujdestar	Gjithsej	Me kujdestar	Gjithsej	Me kujdestar
TOTALI BASHKI	1201	234	179	38	78	78	944	118
Gramsh	420	85	81	15	34	34	305	36
Kushovë	34	6	5	1	3	3	26	2
Pishaj	202	38	21	7	15	15	166	16
Poroçan	85	15	6	1	4	4	75	10
Sult	47	8	4	1	2	2	41	5
Tunjë	84	9	10	0	2	2	72	7
Skënderbegas	69	10	9	1	5	5	55	4
Lenie	33	8	5	1	3	3	25	4
Kodovjat	128	29	16	5	6	6	106	18
Kukur	99	26	22	6	4	4	73	16

Tabela 4: Fëmijë me aftësi të kufizuara sipas grupmoshës dhe njësisë administrative

Njesia Administrative	SIPAS GRUP MOSHAVE			
	Gjithsej	0-6 vjeç	6-15vjeç	15-18
Gramsh	45	7	23	15
Kushovë	6	1	5	0
Pishaj	31	6	18	7
Poroçan	9	3	2	4
Sult	4	1	2	1

Tunjë	7	3	1	3
Skënderbegas	9	2	4	3
Lenie	3	0	2	1
Kodovjat	18	3	11	4
Kukur	9	2	5	2
Total	141	28	73	40

3. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Tabela 5: Raste të rregjistruara apo menaxhuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje viti 2019

Njësia administrative	Fëmijë në nevojë për mbrojtje	Fëmijë pa kujdes prindëror të përkohshëm	Fëmijë të dhunuar/shfrytëzuar	Jetimë	Fëmijë në familje me NE	Fëmijë me AK
Gramsh	10	0	6	2	7	-
Kushovë	-	-	-	-	-	-
Pishaj	3	2	1	1	3	-
Poroçan	-	-	-	-	-	-
Sult	-	-	-	-	-	-
Tunjë	-	-	-	-	-	-
Skënderbegas	-	-	-	2	-	-
Lenie	-	-	-	-	-	-
Kodovjat	3	0	3	0	3	-
Kukur	-	-	-	-	-	-
TOTAL	16	2	10	5	13	0

SHTOJCA 2. SHPORTA E SHËRBIEMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme

Janë dy ligje që ndërthuren dhe që synojnë adresimin e nevojave të familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Ligji 57/2019¹ "Për Asistencën Sociale në Republikën e

Shqipërisë”, dhe Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë”.

Në përputhje me Ligjin 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 11 “Pagesa e ndihmës ekonomike”, ndihma ekonomike është një pagesë e kufizuar në kohë, që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në ligj. Përfitues të ndihmës ekonomike, në përputhje me nenin 6 të po këtij ligji janë: (i) Familjet në nevojë që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme; (ii) Jetimët, të cilët nuk janë në institucione; (iii) Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë; (iv) Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre; (v) Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore; (vi) Fëmijët e vendosur në familje kujdestare sipas përcaktimeve në ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të tij synojnë të ngrenë shërbime të kombinuara që në thelb nxisin fuqizimin e individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Në gusht 2019 Ministria e Financës dhe Ekonomisë (Ministria përgjegjëse për politikën e nxitjes së punësimit) dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (përgjegjëse për politikën e mbrojtjes e përkujdesit social) publikuan një Urdhër të Përbashkët¹ të dy Ministrave që kërkon zbatimin e një Protokollit Bashkëpunimi mes Shërbimit Social Shtetëror dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit me qëllim punësimin e individëve madhorë (në moshë pune) të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

Për fuqizimin e individëve në moshë pune të familjeve të ndihmës ekonomike mund të parashikohen këto ndërhyrje: (i) Program për fuqizimin ekonomik- përfshin një numër masash bazuar në kapacitetet e Bashkisë dhe institucioneve të tjera lokale. (ii) Informimi dhe këshillimi për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për punësim sipas kapacitetit dhe nevojave individuale.

Personat me Aftësi të Kufizuara

Në Shqipëri egziston tashmë një paketë e gjerë ligjore që në thelb synon të garantojë respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Janë tre komponentë të rëndësishëm të ndërthurur tërësisht me njëri-tjetrin që duhen adresuar nga çdo Bashki me qëllim mbrojtjen, përfshirjen dhe përkujdesin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara: (i) Përmeshja e nevojave për shërbime rehabilituese dhe zhvilluese të personave me aftësi të

kufizuara (programi kombëtar i pagesave për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet); (2) garantimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e tyre, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët; (3) garantimi i jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët;

Për personat me aftësi të kufizuara ligji për shërbimet dhe aktet nënligjore të tij parashikojnë këto forma shërbimesh: (i) Shërbime rehabilituese për personat në nevojë për aftësim fizik; (ii) Shërbimet në familje për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare dhe që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal; (iii) Shërbimi i strehimit të mbrojtur për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë.

Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Janë dy ligje që të ndërthurura me njëra tjetrën që janë bazë në analizën për mbrojtjen dhe përkujdesjen për fëmijët: 1. Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Ligji¹nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Në këndvështrimin e garantimit të mbrojtjes që duhet ti mundësohet çdo fëmijë Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, bashkë me detyrat specifike që garantojnë ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave me efektivitet, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë: Bashkia; Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; Njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative; Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Neni 34 në kreun III “Mekanizmat institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton si mekanizëm këshillimor dhe koordinues institucional në nivelin vendor grupin teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative.

Ndërkohë shërbimet kryesore që parashikojnë aktet nënligjore të ligjit 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror janë: (i) Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës; (ii) Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa

kujdes prindëror, për zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislativitetit në fuqi. (iii) Qendrat ditore për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike; (iv) Qendrat ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara; (v) Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese për fëmijë me çrregullime përvazive të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik; (vi) Shërbimi i emergjencës 72 orë për fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;

Viktimat e dhunës në familje

Në përputhje me ligjin 47/2018 që ka sjellë ndryshime të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” njësitë e qeverisjes vendore kanë këto detyra: (i) Angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje; (ii) Instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre; (iii) Ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse. (iv) Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit.

Ndërkohë Bashkia ka detyrimin për ngritjen dhe funksionimin e: (i) Komiteteve Drejtuese lokale që drejtohen nga Kryetari i Bashkisë dhe janë komitete koordinuese ad hoc; (ii) Ekipi teknik ndërdisiplinor që ngrihet me vendim të komitetit drejtues më qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje; (iii) Pranë çdo bashkie caktohet koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore;

Shërbimet bazë të parashikuara nga aktet nënligjore të ligjit për shërbimet sociale për viktimat e dhunës në familje janë: (i) Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; (ii) Shërbimi i emergjencës 72 orë, për viktimat të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. (iii) Shërbimi i

strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje, viktimave të trafikimit të cilët nuk kanë një strehë. Organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale.

Familje që kërkojnë mbështetje për strehim

Ligji 22/2018 “Për strehimin social” përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Programet e strehimit sipas këtij ligji përfshijnë: Bonusi i qerasë; banesa sociale me pagesë të reduktuar; kreditë e buta.

Të moshuar në nevojë për shërbime

Të moshuarit janë një nga grupet e parashikuara në ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Shërbimet e parashikuara në nivel komunitar për ta në aktet nënligjore përfshijnë: (i) Shërbimet në familje për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal. (ii) Qendra ditore për të moshuarit;

Familje që kanë përjetuar divorc

Shërbimet e parashikuara në nivel komunitar për ta përfshijnë shërbimin psikosocial. Megjithatë nevojat përcaktohen gjatë menaxhimit të rasteve dhe shpesh janë më komplekse. Ato mund të përfshijnë edhe strehimin social.

Përdorues të alkoolit

Shërbimet e parashikuara në nivel komunitar për ta përfshijnë shërbimin psikosocial.

SHTOJCA 4. BUXHETI I DETAJUAR

Formati excel bashkangjitur